



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 6 regjistër (JR)
Datë 27.01.2022

Nr. 48 i vendimit
Datë 15.12.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 15.12.2022, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare znj. Marie Tuma, me sekretare gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 6/2022 (JR), datë 27.01.2022, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ervin Trashi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 474, datë 12.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F, pika 2, i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 63, 66 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili kërkoi prishjen e vendimit nr. 474, datë 12.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ervin Trashi, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), ushtronte funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, iu nënshtroa procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”) në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.
4. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi, ka dërguar në Komision një raport në të cilin ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; si dhe (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
5. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK), pasi ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. {***} prot., datë 02.11.2017, në të cilin ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, si më sipër,

kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Ervin Trashi, bazuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe të figurës, duke marrë në përfundim të procesit, vendimin nr. 474, datë 12.11.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Me vendimin nr. 474, datë 12.11.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të ankuesit, bazuar në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë dhe të figurës, dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Ervin Trashi nuk arrin nivelin kualifikues, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, për sa u takon kriterëve të kontrollit të pasurisë dhe figurës, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
8. Komisioni, bazuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit kundër vendimit nr. 474, datë 12.11.2021, të Komisionit, duke pretenduar se vendimi objekt ankimi është marrë nga një trup gjykues që nuk përmbush kriteret e një gjykate të pavarur dhe të paanshme dhe është rezultat i një procesi të paragjykuar dhe në kundërshtim me provat.
10. Shkaqet e ankimit, lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

10.1. Vendimi në Komision është marrë nga një trup gjykues që nuk përmbush kriterin e “një gjykate të krijuar me ligj”, sipas nenit 6 të KEDNj-së, pasi anëtarët e tij nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj për t’u përzgjedhur si të tillë, si dhe statusi dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre i bën ata vulnerabël dhe jo të pavarur. Trupi gjykues nuk përmbush kriterin e të qenit “gjykatë e pavarur dhe e paanshme”, sipas nenit 6 të KEDNj-së, pasi kryerja njëkohësisht e hetimit dhe vendimmarrjes, po nga e njëjta trupë gjykuese e Komisionit, nuk garanton procesin e rregullt ligjor.

10.2. Trupi gjykues ka qenë i njëanshëm dhe diskriminues në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës dhe nenin 17 të Kodit të Procedurave Administrative.

10.3. Hetimi dhe vlerësimi administrativ ka qenë i cekët, paragjykues, në kundërshtim me provat dhe me praktikën unifikuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe të vetë trupit gjykues që shqyrtoi çështjen.

10.4. Trupi gjykues ka shkelur parimet e parashikuara në nenin 6, pika 3, shkronja “d” të KEDNj-së, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të drejtën e kundërshtimit të provave të krijuara nga vetë Komisioni, nuk është njohur me ekspertët që kanë kryer vlerësimet ekonomike, nuk i është dhënë e drejta të verifikojë kushtet e mospasjes së konfliktit të interesit të tyre, duke iu cenuar e drejta për një mbrojtje efektive.

10.5. Vendimi nr. 474, datë 12.11.2021, i Komisionit është i paligjshëm për shkak se vjen në kundërshtim me nenet D, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me nenet 4, 33, 61 etj., të ligjit

nr. 84/2016 dhe se Komisioni ka aplikuar, në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin, masën disiplinore *shkarkim nga detyra*.

11. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si në vijim.

11.1. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 56 m², ndodhur në {*}, Vlorë**

11.1.1. Pavarësisht konkluzionit të Komisionit se në rubrikën ku është deklaruar pasuria nuk është përcaktuar burimi i saj, subjekti ka deklaruar kontratën e kredisë, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë. Mungesa e përcaktimit të burimit të blerjes së apartamentit në deklaratën *vetting*, sa kohë që nuk ka shërbyer për të fshehur pasurinë, pavarësisht se mund të cilësohet si pasaktësi, nuk duhet të ishte vlerësuar në dëm të subjektit të rivlerësimit.

11.1.2. Lidhur me konstatimin e Komisionit, për mospërputhjen e çmimit të blerjes së apartamentit me deklaratimet në deklaratën periodike vjetore 2008, kontratën e porosisë dhe kontratën e shitjes, subjekti parashtron se ka argumentuar në mënyrë bindëse dhe me prova se çmimi i apartamentit nuk ka qenë 27.000 euro, por 24.000 euro dhe burimi i krijimit ka qenë i ligjshëm. Çmimi i shitjes i përcaktuar në kontratën e shitjes nr. {***}, datë 27.09.2012, është 27.000 euro, por për shkak të të metave të apartamentit palët kanë rënë dakord që këto të meta të konsiderohen si punime të kryera nga blerësi në shumën 3.000 euro dhe blerësi të paguante vetëm shumën 24.000 euro.

11.1.3. Subjekti kundërshton si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme investimin në total prej 27.000 eurosh, si dhe shlyerjen e kredisë prej 20.000 eurosh, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës, dorëzuar në tetor 2007, subjekti ka deklaruar shumën 400.000 lekë *cash*, e cila është përdorur në vitin 2008 për pagesën e shumës 4.000 euro për blerjen e apartamentit në {***}. Ndërsa lidhur me huanë e vëllait të subjektit të rivlerësimit në vlerën 1.800.000 lekë, në vitin 2011, përdorur për shlyerjen e kredisë në ish NBG Bank, subjekti pretendon se Komisioni ka gabuar kur ka konkluduar se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur mundësi të provojë të ardhurat e ligjshme për dhënien e huasë, dhe se kjo hua nuk ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, por është marrë për të zvogëluar shpenzimet e kredisë.

11.2. Lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë me kontratën nr. {*}, datë 27.12.2016**

11.2.1. Subjekti i rivlerësimit parashtron se mosdeklarimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting* ka qenë një lapsus dhe nuk mund të interpretohet si e qëllimshme, pasi nuk ka pasoja konkrete sa kohë nuk ka shërbyer si mjet për të fshehur pasurinë apo pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj.

11.2.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit se nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2016 pasi, sipas tij, dhe rezultati financiar në vitin 2016 duhet të jetë pozitiv, pasi Komisioni ka llogaritur gabim shpenzimet e transportit, shpenzimet e udhëtimeve, si dhe shpenzimet jetike.

11.2.3. Për sa i përket përdorimit të automjetit, subjekti parashtron se për shkak të marrëdhënieve familjare dhe shoqërore e ka përdorur njëkohësisht me pronarin e automjetit, dhe se nuk e ka fshehur përdorimin e tij, pasi e ka deklaruar me aktin noterial nr. {***} rep., datë 18.10.2012.

11.3. Lidhur me automjetin tip “Nissan Primera”, blerë me kontratën e blerjes nr. {*}, datë 15.10.2007**

11.3.1. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit, duke pretenduar se nga interpretimi i të gjitha parashikimeve ligjore për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e automjeteve, rezulton se e ardhura e përfituar si fitim midis çmimit të shitjes dhe të blerjes së automjeteve nuk është e ardhur e tatueshme dhe në legjislacionin e kohës nuk ka pasur procedurë të përcaktuar për mbledhjen e këtij tatimi, në këto kushte ai nuk ka pasur detyrim ligjor për pagesën e ndonjë detyrimi tatimor për këtë të ardhur.

11.4. Lidhur me shtëpinë e banimit në adresën: lagja “{*}”, rruga “{***}”, Lushnjë, në pronësi të prindërve**

11.4.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit se ka kryer deklarime të pasakta dhe kontradiktore, si dhe nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme ndërtimin e katit të tretë papafingo gjatë periudhës që ka qenë në detyrë, pasi subjekti nuk është bashkëpronar dhe nuk ka kontribuar në pasuritë e prindërve. Kjo shtëpi është ndërtuar para se subjekti të fillonte punën si gjyqtar dhe nuk duhet të përfshihet në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, pasi në këtë shtëpi ai ka vetëm të drejta banimi.

11.5. Lidhur me pasurinë e prindërve, gjendjen cash 1.000.000 lekë, deklaruar nga babai i subjektit në deklaratën vetting

11.5.1. Subjekti kundërshton konstatimin e Komisionit se personi i lidhur A. T. nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* burimin e ligjshëm të likuiditetit *cash* prej 1.000.000 lekësh, duke prapësuar se pasaktësitë e mundshme të deklaratës *vetting* nga prindërit e subjektit nuk mund të penalizojnë atë. Këto të ardhura nuk janë deklaruar më parë, pasi prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë qenë subjekte deklaruese, sipas ligjit nr. 9049/2003. Gjendja *cash* është pasuri e prindërve e krijuar nga kursimet gjatë gjithë jetës dhe subjekti nuk ka kontribuar në krijimin e saj.

11.6. Lidhur me konstatime të tjera të Komisionit

11.6.1. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se arsyetimi dhe vlerësimi i Komisionit, lidhur me qëndrimin e subjektit, bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, është abuziv, pasi ky vlerësim duhet të jetë i mbështetur në rrethana objektive në mënyrë që të jetë i verifikueshëm. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me përdorimin e automjetit në pronësi të xhaxhait G. T. në periudhën 2011-2012, u është përgjigjur në çdo rast pyetësorëve brenda afatit të kërkuar dhe shpjegimet e tij kanë qenë konsistente. Subjekti ka dhënë ato sqarime që ka pasur mundësi të gjejë, pasi sendi nuk ekziston as fizikisht dhe as juridikisht, si dhe ka qenë në pamundësi të marrë dokumentacionin e mjetit në organin e ngarkuar me ligj për ruajtjen e informacionit.

11.7. Shkaqet e ankimit lidhur me analizën financiare

11.7.1. Sipas subjektit të rivlerësimit nga Komisioni nuk është respektuar ligji dhe parimi i sigurisë juridike, parimi i diskrecionit, proporcionalitetit dhe i objektivitetit në llogaritjen e shpenzimeve jetike. Sipas subjektit, në vështrim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nuk ka asnjë parashikim ligjor se si llogariten shpenzimet e jetesës dhe Komisioni në vendimmarrjen e tij ndaj subjektit ka shkelur parimin e sigurisë juridike, pasi mungon ligji ku duhej të referohej, si dhe ka realizuar një vendimmarrje të ndryshme bazuar në rrethana të ngjashme dhe metodologji të ndryshme.

Komisionit nuk i është dhënë e drejta të ushtrijë diskrecionin në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës sipas vlerësimit të tij.

11.7.2. Komisioni, në shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk ka marrë për bazë rast pas rasti dhe vit pas viti strukturën e buxhetit të familjes. Komisioni ka llogaritur përveç shpenzimeve të prezumuara, sipas strukturës së buxhetit të familjes, edhe shpenzime të kryera nga subjekti me të njëjtin qëllim dhe të të njëjtës natyrë duke e ngarkuar subjektin atë dy herë me këto shpenzime.

11.7.3. Në analizë subjekti është ngarkuar në mënyrë të dyfishtë me shpenzime edhe për ditët për të cilat ka qenë jashtë shtetit, duke llogaritur shpenzime jetike, por edhe shpenzime për udhëtime.

11.7.4. Në analizën e Komisioni lidhur me shpenzimet e transportit nuk janë përcaktuar saktë ditët e punës, pasi nuk është mbajtur parasysh që kohëzgjatja e lejes vjetore për gjyqtarët nuk ka qenë 30 ditë por 40 ditë, si dhe nuk janë zbritur ditët e festave zyrtare.

11.7.5. Subjekti kërkon reduktimin e shpenzimeve të llogaritura nga Komisioni, (për transportin, për udhëtimet, sipas të dhënave nga sistemi *TIMS*, për mobilimin dhe për qiranë), në bazë të përqindjeve që janë pjesë përbërëse e shpenzimeve të jetesës, sipas strukturës së buxhetit të familjes, sipas INSTAT, përkatësisht: (a) shpenzimet e udhëtimeve të reduktohen në masën 3.2% - 5%; (b) shpenzimet e transportit, të reduktohen në masën 5.7%-6.8%; (c) shpenzimet e mobilimit, të reduktohen në masën 4.9% - 5.9%; (ç) shpenzimet e qirasë, për vitet 2009-2011, të reduktohen në masën 7.4%.

11.7.6. Sipas subjektit të rivlerësimit diferenca negative prej 5.993.356 lekësh, sipas analizës financiare të Komisionit, është artificiale, pasi në mënyrë të padrejtë nuk është mbajtur parasysh huaja prej 1.800.000 lekësh marrë nga vëllai, kursimet para vitit 2008 në vlerën 4.000 euro ose 492.000 lekë (sipas kursit të këmbimit mesatar të vitit 2008), është ngarkuar me shpenzime për banesën e prindërve në masën 2.645.097 lekë, është ngarkuar me shpenzime të pakryera për apartamentin në {***} në masën 416.830 lekë. Edhe në rast se do të pranoheshin shpenzimet jetike në masën e llogaritur nga Komisioni, pa përfshirë të ardhurat e ligjshme nga aktiviteti bujqësor, diferenca negative do të ishte 639.429 lekë, e shpërndarë në 10 vjet.

12. Shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës paraqiten në mënyrë të përmbledhur si në vijim.

12.1. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se ka bërë deklaram të pasaktë në formularin për kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se sipas interpretimit të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, subjektet për të cilat është marrë vendim pushimi nga prokuroria, për shkaqe të ndryshme nga fjalia e dytë e pikës 15, nuk konsiderohen *persona të përfshirë në krimin e organizuar*. Subjekti pretendon se në kohën e plotësimit të formularit nuk ka qenë person i proceduar penalisht për asnjë vepër penale, përfshirë edhe vepra të parashikuara në pikën 1, të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

13. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

14. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), fillimisht mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi vendimin nr. 474, datë 12.11.2021, të Komisionit Në këndvështrim të pretendimeve të parashtruara në ankim nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe konstatimin në mënyrë të plotë të gjendjes faktike, trupi gjykues nuk evidentoi shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, të cilat në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, do të sillnin nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike për korrigjimin e tyre.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit

16. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se vendimi në Komision është marrë nga një trup gjykues që nuk përmbush kriterin e *një gjykate të krijuar me ligj, të pavarur dhe të paanshme* sipas nenit 6 të KEDNj-së, Kolegji analizon si vijon.

16.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se trupi gjykues që ka shqyrtuar çështjen e tij nuk përmbush kriterin e *një gjykate të krijuar me ligj*, sipas nenit 6 të KEDNj-së, pasi anëtarët e tij nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj për t'u përzgjedhur si të tillë, si dhe statusi dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre i bën ata vulnerabël dhe jo të pavarur. Lidhur me sa pretendon subjekti, Kolegji sjell në vëmendje qëndrimin e tij për [...] *natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit, që në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t'i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve*

edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroj vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t'i paraprinte emërimin fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t'i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Së fundmi, në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNj-ja, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Këto të drejta, në rrethanat konkrete, pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, konsiderohen të adresuara nga kontrolli i gjithanshëm i vendimit të Komisionit, kryer në Kolegj¹.

16.2. Për sa i përket pretendimit të subjektit se trupi gjykues nuk ka qenë i paanshëm, pasi kryerja njëkohësisht e hetimit dhe vendimmarrjes po nga e njëjta trupë gjykuese e Komisionit, nuk garanton procesin e rregullt ligjor dhe në këtë rast, duke referuar qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen *Volkov vs Ukrainë, një dublim i tillë i funksioneve mund të hedhë dyshime objektive mbi paanshmërinë e atyre anëtarëve*, Kolegji sjell në vëmendje se sipas dispozitave kushtetuese Komisioni është një organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili kryen rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas një procedure e cila garanton respektimin e parimeve të procesit të rregullt dhe të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit. Mënyra e krijimit, veprimtaria e Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, që i është nënshtruar kontrollit mbi kushtetutshmërinë nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, ka arsyetuar: *“Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra, organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së [...]”*.

16.3. Trupi gjykues vëren se në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* GjEDNj-ja ka vlerësuar se nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të Komisionit për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm nuk mund të konsiderohen se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të subjektit kërkues në seancë publike. Si rrjedhojë, e, sa më sipër, kjo Gjykatë ka konkluduar se nuk ka shkelje të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së në drejtim të parimit të gjykatës së paanshme².

¹ Shih vendimin nr. 43/2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 14.2.iv.

² Shih paragrafët 280-317, të vendimit të GjEDNj-së.

16.4. Në përfundim të analizës së mësipërme, Kolegji vlerëson se nuk jemi para rastit të cenimit të nenit 6 të KEDNj-së në drejtim të nocionit të *gjykatës së pavarur dhe të paanshme dhe të krijuar me ligj*, sikundër pretendon subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij.

17. Subjekti i rivlerësimit pretendon se trupi gjykues ka qenë i njëanshëm dhe diskriminues në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës³ dhe nenin 17 të Kodit të Procedurave Administrative⁴, pasi: (i) ka shqyrtuar dhe rrëzuar kërkesën për çeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e aftësisë profesionale pa dëgjuar subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore dhe pa e njoftuar për vendimin e marrë në datën 05.11.2021;(ii) nuk i është komunikuar që seanca e datës 12.11.2021 do të ishte për shpalljen e vendimit;(iii) nuk është shqyrtuar kërkesa e subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e seancës dëgjimore të datës 12.11.2021.

18. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, Kolegji, pas verifikimit të dokumentacionit të sjellë nga Komisioni për procedurat e zhvilluara, konstaton dhe vlerëson se:

18.1. Me vendimin nr. {***}, datë 28.10.2021, trupi gjykues i Komisionit, pas kërkesës së subjektit të rivlerësimit ka vendosur: (i) shtyrjen e afatit për dërgimin e shpjegimeve dhe dokumentacionit mbështetës deri në datën 05.11.2021;(ii) të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore më datë 09.11.2021; si dhe (iii) arsyetimi i këtij vendimi të ndërmjetëm do të jetë pjesë e arsyetimit të vendimit përfundimtar. Ndërsa në vendimin nr. {***}, datë 05.11.2021, trupi gjykues ka vendosur: (i) rrëzimin e kërkesave të subjektit për riçeljen e hetimit administrative, duke përfshirë shqyrtimin e kriterit të aftësisë profesionale dhe marrjen e provave të reja duke thirrur dëshmitarë; si dhe (ii) të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore më datë 09.11.2021.

18.2. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar për seancën dëgjimore, me dy e-mail-et e datave 29.10.2021 dhe 05.11.2021. Në e-mail-in e datës 05.11.2021, subjektit i është njoftuar edhe vendimi për mospranimin e kërkesës për riçeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e aftësive profesionale, pasi është çmuar të bëhet vlerësimi i të gjithë parashtrimeve dhe provave të paraqitura dhe atyre që mund të paraqiste subjekti në vijim, në seancën dëgjimore dhe, më pas, trupi gjykues do të vlerësonte dhe vendoste në lidhje me provueshmërinë e tyre në funksion të kundërshtimit të barrës së provës, si dhe riçeljen e hetimit administrativ. Me e-mail-in e datës 06.11.2022, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar marrjen dijeni. Nga të gjithë aktet e përmendura më sipër rezulton se janë të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit se i janë rrëzuar kërkesat pa u dëgjuar dhe se nuk është njoftuar për vendimin e datës 05.11.2021.

18.3. Kolegji vlerëson të pabazuar dhe pretendimin se Komisioni ka shtyrë seancën dëgjimore në datën 12.11.2021, pa i komunikuar subjektit që kjo seancë ishte për shpalljen e vendimit, pasi nga procesverbali i seancës dëgjimore të datës 09.11.2021, rezulton se në fund të seancës kryesuesja është shprehur se *në këto kushte, trupi gjykues tërhiqet për një vendimmarrje, sipas vlerësimit të çështjes në tërësi [...]*. Pra, subjekti pjesëmarrës në këtë seancë ka qenë i njohur me faktin se trupa po tërhiqej për vendim dhe se seanca e radhës, për shpalljen e vendimit, do të ishte më datë 12 nëntor 2021. Për sa më sipër, rezulton se Komisioni ka kryer veprimet e duhura procedurale për

³ Neni 18 “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit [...]”.

⁴ Neni 17 Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit: “1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë.2. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë”.

zhvillimin e seancës dëgjimore dhe shpalljen e vendimit, sipas parashikimeve të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë nen, në pikën 6 parashikohet se *vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore* dhe këtë parashikim ka pasur parasysh Komisioni në njoftimin që seanca do të rifillonte në datën 12.11.2021.

18.4. Subjekti ka parashtruar në ankim se seanca e datës 12.11.2021 është zhvilluar në mungesë të tij, pasi ai kishte njoftuar paraprakisht Komisionin, për shkak objektiv për mosparaqitjen. Sipas subjektit, zhvillimi i seancës dëgjimore në mungesë të tij, megjithëse kishte shkak të arsyeshëm për të përligjur mosparaqitjen, veprim që Komisioni nuk e ka kryer me asnjë subjekt tjetër rivlerësimi, provon njëanshmërinë e Komisionit. Bazuar në nenin 17/2 të Kodit të Procedurave Administrative, trupi gjykues duhet të mbante të njëjtin qëndrim që ka mbajtur me subjekte të tjera rivlerësimi.

18.4.1. Lidhur me këtë pretendim, nga aktet rezulton se me e-mail-in e datës 12.11.2021, ora 8:35 a.m., subjekti i rivlerësimit ka njoftuar se për shkak të gjendjes shëndetësore e kishte të pamundur të ishte i pranishëm në seancën e asaj dite, si dhe ka kërkuar shtyrjen e seancës për një ditë tjetër. Bashkëlidhur subjekti ka dërguar dhe një raport për paaftësi të përkohshme në punë. Sipas procesverbalit të seancës së datës 12.11.2021, në fillim të seancës është konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ishte prezent dhe është vazhduar me shpalljen e vendimit. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Kolegji vëren se pavarësisht mospjesëmarrjes së subjektit në seancën për shpalljen e vendimit nuk ka pasur cenim të të drejtës së tij për t'u dëgjuar, pasi në seancën pararendëse ai ka paraqitur gjithë argumentet dhe kundërshtimet e tij, lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe kërkimet përfundimtare.

19. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim se Komisioni ka interpretuar provat në mënyrë të pjesshme, se nuk ka pasur të drejtën e kundërshtimit të provave të krijuara nga vetë Komisioni dhe se vendimi nuk është i arsyetuar sipas rrethanave dhe fakteve të provuara në procedurën hetimore dhe në disa raste duke deformuar të vërtetën.

19.1. Referuar përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se Komisioni në të gjithë arsyetimin e tij rendit faktet, rrethanat, provat dhe ligjin e zbatueshëm në analizën e çdo pasurie apo të ardhure të subjektit të rivlerësimit. Subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia të njihet me rezultatet paraprake të hetimit dhe pas kalimit të barrës së provës i janë dhënë të gjitha garancitë të paraqesë shpjegime dhe kundërshtime me shkrim dhe me gojë, si dhe të sjellë provat që ka çmuar të nevojshme. Për çdo gjetje, si rezultat i hetimit administrativ, Komisioni ka analizuar gjithë aktet, përfshirë dhe ato të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit⁵, sqarimet e subjektit në pyetësorë, si dhe në prapësimet e rezultateve të hetimit. Kolegji konstaton se veprimet e Komisionit kanë qenë në përputhje me garancitë për proces të rregullt mbi arsyetimin e vendimit, gjykimin kontradiktor dhe

⁵ Në vendimin nr. 474, Komisioni është shprehur: "41.5 [...] Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti paraqiti disa dokumente shkresore. Bashkëlidhur me parashtrimet shih: (i) deklarata me vërtetim nënshkrimesh lëshuar nga shtetasit Z. Z., Sh. H., G. Sh., K. B., L. L., A. A., I. L., Sh. K., S. K., Z. V., Sh. B. dhe B. N., të cilët kanë pranuar faktin se vëllai i tij G. T. ka kryer shërbime teknike-elektrike dhe montim të kondicionerëve, duke përcaktuar edhe shumat e marra nga secili prej këtyre shtetasve; (ii) deklarata me vërtetim nënshkrimesh nga shtetasit A. Ç., K. L., B. S., B. D., K. Gj., F. H., L. S., G. C. dhe D. R., të cilët kanë pohuar faktin se vëllai i tij G. T. ka punuar për llogari të subjektit A. C., për riparim të ekspresëve të kafesë në aktivitetin e tyre privat. [...] Në analizë të parashtrimeve të subjektit dhe akteve shkresore të paraqitura si në parashtrime, ashtu edhe gjatë hetimit administrativ, ...subjekti nuk ka mundur të provojë me dokumentacion të ardhura të ligjshme të huadhënësit G. T., në kuptim të pikës 3, të nenit D, të ligjit nr. 84/2016 [...]".

barazinë e armëve dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim nuk qëndrojnë, pasi janë të pambështetura në provat e administruara.

19.2. Lidhur me sa pretendon subjekti, që Komisioni ka deformuar dhe pasqyruar në mënyrë të rreme rrethanat, duke iu referuar pikës 37.6 të vendimit, Kolegji konstaton se me shkresën nr. {***} prot., datë 21.09.2021, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ka informuar Komisionin se nuk rezulton që në emër të shtetasit G. A. T. të jetë regjistruar ndonjë procedim penal apo pasuror. Nga konteksti i paragrafit, 37.6, konkretisht të togfjalëshit *po kështu* me të cilin fillon fjalia e dytë, konkludohet se bëhet fjalë për një lapsus të Komisionit, që ka dashur të shprehet që *nuk janë evidentuar procedime penale [...]*. Pra, në këtë rast, nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit për njëanshmëri dhe shtrembërim të fakteve nga Komisioni. Për më tepër, Kolegji vëren se fakti i gjendjes së procedimeve penale të vëllait të subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë relevant në vlerësimin nga Komisioni të marrëdhënies së huasë midis tyre.

20. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se arsyetimi i Komisionit, në vendimin objekt shqyrtimi, vjen në kundërshtim me praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit në raste të ngjashme, sillet në vëmendje qëndrimi i Kolegjit se: *“Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat lidhen me vlerësimin e kritereve të rivlerësimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar me vendimmarrje të mëparshme të tij⁶”*.
21. Kolegji vlerëson si të pabazuar në ligj dhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se këshilltarët e Komisionit nuk mund të konsiderohen ekspertë të pavarur, dhe se nuk ka pasur mundësi të verifikojë kushtet e mospasjes së konfliktit të interesit të tyre. Sipas qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit, këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, referuar parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, ushtrojnë veprimtari këshilluese dhe ndihmëse dhe nuk kanë kompetenca vendimmarrëse në çështjet e rivlerësimit kalimtar. Analizat financiare të kryera prej tyre, jo vetëm i nënshtrohen debatit nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit por dhe, në përfundim, lidhur me to vendos trupi gjykues i ngarkuar për kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, vlerësohet se nuk jemi para rastit të shkeljes së dispozitave ligjore lidhur me konfliktin e interesit.⁷
22. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se vendimi nr. 474, datë 12.11.2021, i Komisionit është i paligjshëm, për shkak se vjen në kundërshtim me nenet D, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me nenet 4, 33, 61 etj., të ligjit nr. 84/2016 dhe se Komisioni ka aplikuar, në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin, masën disiplinore *shkarkim nga detyra*, Kolegji çmon se vlerësimi i këtij pretendimi ka të bëjë me vlerësimin tërësor të çështjes, në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

*i) Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 56 m², ndodhur në {***}, Vlorë*

23. Komisioni për këtë pasuri ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të kundërshtojë barrën

⁶ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 7/2019 (JR), nr. 34/2021 (JR).

⁷ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 8/2022, (JR), nr. 23/2022 (JR).

e provës, pasi ka kryer: (i) deklaramë të pasakta dhe në kundërshtim me ligjin, sipas gërmës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme, sipas gërmës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, investimin në total prej 27.000 eurosh, si dhe shlyerjen e kredisë prej 20.000 eurosh.

24. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion, pasi gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

24.1. Evidentohet një paqartësi në lidhje me çmimin e shitjes së pasurisë, për shkak të mospërputhjes me vlerën e shënuar në të dyja kontratat, në DPV-në për vitin 2008, ku çmimi është 27.000 euro, me DPV-në për vitin 2012 dhe deklaratën *vetting*, ku vlera e pasurisë është deklaruar 24.000 euro.

24.2. Në DPV-në për vitin 2008, kur është lidhur kontrata e porosisë, si dhe në DPV-në 2012, kur është lidhur kontrata e shitjes, por edhe në deklaratën *vetting*, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë sipas ligjit.

24.3. Në rubrikën “Detyrimet financiare” të DPV-së për vitin 2008, subjekti ka deklaruar një kredi, si dhe faktin që ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë, ndërsa në seksionin e detyrimeve të deklaratës *vetting* ka deklaruar: *Kontratë kredie bankare nr. {***}, datë 29.09.2008, në shumën 20.000 euro. Qëllimi: për blerje apartamenti në {***}, Vlorë.* Ndërsa në deklaratën *vetting*, në rubrikën e detyrimeve, subjekti ka deklaruar: *Kontratë huaje nr. {***}, datë 25.01.2011, shuma e detyrimit 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë. Kjo shumë jepet me qëllim shlyerjen e kontratës së kredisë bankare nr. {***}, datë 29.09.2008. Shlyer plotësisht detyrimi në dhjetor të vitit 2015.* Por, sikurse ka rezultuar nga hetimi administrativ, përveç kredisë në shumën 20.000 euro, subjekti ka përdorur edhe të ardhura të tjera për investimin e pjesës së mbetur prej 7.000 eurosh dhe, për këtë arsye, ka qenë i domosdoshëm deklarimi i burimit të krijimit të pasurisë në rubrikën përkatëse të deklaratës *vetting*, sipas parashikimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

25. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, lidhur me krijimin e kësaj pasurie, si konkluzion i arritur pa marrë në konsideratë asnjë provë dhe argument ligjor të paraqitur prej tij, duke parashtruar si vijon.

25.1. Lidhur me konkluzionin e Komisionit se në DPV-të 2008 dhe 2012, si dhe në deklaratën *vetting*, në rubrikën ku është deklaruar pasuria nuk është përcaktuar burimi i saj, subjekti parashtron se në të njëjtën deklaratë periodike ka deklaruar kontratën e kredisë, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë. Mungesa e përcaktimit të burimit të blerjes në deklaratën *vetting*, sa kohë që nuk ka shërbyer për të fshehur pasurinë, pavarësisht se mund të cilësohet si pasaktësi, nuk duhet të ishte vlerësuar në dëm të subjektit të rivlerësimit.

25.2. Lidhur me konstatimin e Komisionit, për mospërputhjen e çmimit të blerjes së apartamentit me deklarimet në DPV-në 2008, kontratën e porosisë 2008 dhe kontratën e shitjes 2012, subjekti i rivlerësimit parashtron se ka argumentuar në mënyrë bindëse dhe me prova se çmimi i apartamentit nuk ka qenë 27.000 euro, por 24.000 euro dhe burimi i krijimit ka qenë i ligjshëm. Çmimi i shitjes i përcaktuar në kontratën e shitjes nr. {***}, datë 27.09.2012, është 27.000 euro, por për shkak të të metave të sendit/apartamentit palët kanë rënë dakord që të metat e sendit të konsiderohen si punime të kryera nga blerësi në shumën 3.000 euro dhe blerësi të paguante vetëm 24.000 euro. Me aktin noterial të datës 29.10.2021, palët kanë interpretuar kontratën e tyre me qëllim që të qartësohej Komisioni. Shuma 24.000 euro është çmimi që është paguar efektivisht nga subjekti dhe diferenca 3.000 euro, me të cilën është ulur çmimi, nuk duhet të përfshihet në

analizën financiare të viteve 2010, 2011 dhe 2012, duke qenë se janë shpenzime që nuk janë kryer nga subjekti.

25.3. Lidhur me deklarimin e shumës 400.000 lekë *cash*, e cila është përdorur në vitin 2008 për pagesën e shumës 4.000 euro për blerjen e apartamentit në {***}, pavarësisht pasaktësisë në deklaratën periodike të vitit 2008, kjo shumë rrjedh nga burime të ligjshme që janë të ardhurat e bursës së Shkollës së Magjistraturës. Është e vërtetë që në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 subjekti nuk e ka përsëritur deklarimin në lidhje me këtë shumë, por ka vlerësuar se në deklaratën periodike deklarohen ndryshimet e pasurisë dhe kjo shumë nuk kishte ndryshuar.

25.4. Lidhur me huanë e vëllait G. T. në vlerën 1.800.000 lekë, në vitin 2011, përdorur për shlyerjen e kredisë në ish-NBG (ABI Bank aktualisht), Komisioni ka gabuar kur ka konkluduar se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur mundësi të provojë të ardhurat e ligjshme për dhënien e huasë prej 1.800.000 lekësh, pasi:

- a) është vërtetuar që dhënësi, personi tjetër i lidhur, ka kryer punë që gjeneron të ardhura;
- b) është vërtetuar që mospagimi i detyrimeve tatimore në kohën e krijimit të të ardhurave ka ardhur nga pakujdesia e personit tjetër të lidhur dhe e punëdhënësit të tij dhe nuk ka pasur për qëllim fshehjen e të ardhurave apo shmangien e ndonjë detyrimi, krijimin e ndonjë përfitimi të paligjshëm për të;
- c) është vërtetuar që subjekti i rivlerësimit nuk ka krijuar pasuri me huanë e dhënë, pasi huaja ishte kthyer nga të ardhurat e pagës së subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka përbërë dhuratë, si dhe duhet të kishte përfshirë në analizën e vitit 2011 vlerën e huasë prej 1.800.000 lekësh si të ardhura.

25.5. Huaja e dhënë nga vëllai nuk ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit dhe se subjekti ka pasur mundësi për të shlyer këstin mujor të kredisë që ka qenë afërsisht sa 1/3 e pagës mujore. Huaja është marrë për të zvogëluar shpenzimet e kredisë si ndihmë midis vëllezërish.

25.6. Lidhur me konkluzionin e Komisionit se nuk ka pasur mundësi për shlyerjen e huasë vëllait me burime të ligjshme, në analizë të viteve 2011-2015, nuk duhet të përfshihej vlera prej 3.000 eurosh si shpenzime për punimet në apartamentin në {***}, Vlorë, duhet të ndryshonte llogaritja e shpenzimeve, duke kryer reduktimet përkatëse e sipas analizës së subjektit, ashtu siç ka pretenduar dhe në rezultatet hetimore.

25.7. Subjekti parashtron se pavarësisht konkluzionit të Komisionit se në rubrikën ku është deklaruar pasuria nuk është përcaktuar burimi i saj, ai ka deklaruar kontratën e kredisë, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë. Mungesa e përcaktimit të burimit të blerjes së apartamentit në deklaratën *vetting*, sa kohë që nuk ka shërbyer për të fshehur pasurinë, pavarësisht se mund të cilësohet si pasaktësi, nuk duhet të ishte vlerësuar në dëm të subjektit të rivlerësimit.

25.8. Lidhur me konstatimin e Komisionit, për mospërputhjen e çmimit të blerjes së apartamentit me deklaratimet në deklaratën periodike vjetore 2008, kontratën e porosisë dhe kontratën e shitjes, subjekti parashtron se ka argumentuar në mënyrë bindëse dhe me prova se çmimi i apartamentit nuk ka qenë 27.000 euro, por 24.000 euro dhe burimi i krijimit ka qenë i ligjshëm. Çmimi i shitjes i përcaktuar në kontratën e shitjes nr. {***}, datë 27.09.2012, është 27.000 euro, por për shkak të të metave të apartamentit palët kanë rënë dakord që këto të meta të konsiderohen si punime të kryera nga blerësi në shumën 3.000 euro dhe blerësi të paguante vetëm 24.000 euro.

25.9. Subjekti kundërshton si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme investimin në total prej 27.000 eurosh, si dhe shlyerjen e kredisë prej 20.000 eurosh, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës, dorëzuar në tetor 2007, subjekti ka deklaruar shumën 400.000 lekë *cash*, e cila është përdorur në vitin 2008 për pagesën e shumës 4.000 euro, për blerjen e apartamentit në {***}. Ndërsa lidhur me huanë e vëllait të subjektit të rivlerësimit në vlerën 1.800.000 lekë, në vitin 2011, përdorur për shlyerjen e kredisë në ish-NBG, subjekti pretendon se Komisioni ka gabuar kur ka konkluduar se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur mundësi të provojë të ardhurat e ligjshme për dhënien e huasë, dhe se kjo hua nuk ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, por është marrë për të zvogëluar shpenzimet e kredisë.

26. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, Kolegji, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar *apartament banimi me sipërfaqe 56 m², ndodhur në {***}, Vlorë, kontrata e blerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.09.2012, vlera e pasurisë 24.000 euro, pjesa takuese: 100 %*. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie. Në DPV-në 2008, subjekti ka deklaruar *apartament me sip. 55,7 m² me adresë {***}, Vlorë, blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2008, në vlerën 27.000 euro, pjesa takuese: 100 %*, pa deklaruar burimin e krijimit. Në DPV-në 2012, subjekti ka deklaruar *apartament banimi me sip. 56,18 m² ndodhur në {***}, Vlorë, në vlerën 24.000 euro*, pa deklaruar burimin e krijimit të pasurisë.
27. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, vendimit të Komisionit, si dhe të akteve të depozituara në Komision, Kolegji konstaton dhe vlerëson si vijon.

Për sa i përket çmimit të blerjes së apartamentit

28. Komisioni ka konkluduar se investimi në blerjen e apartamentit në {***} është vlera prej 27.000 eurosh, sikurse është përcaktuar në kontratën e shitjes me nr. {***}, datë 27.09.2012 dhe likuidimi i kësaj shume është bërë sipas mënyrës së përcaktuar në këtë kontratë.
29. Kolegji vëren nga aktet e Komisionit se sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore lëshuar në datën 03.10.2012, regjistrimi i pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit, pas shitjes nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, është bërë sipas kontratës së shitjes nr. {***}, datë 27.09.2012.
30. Nga kontrata e porosisë, datë 04.09.2008, rezulton se çmimi i shitjes së apartamentit ka qenë 27.000 euro, nga të cilat 24.000 euro do të paguheshin në momentin e miratimit të kredisë prej bankës. Në kontratën e shitblerjes së datës 27.09.2012 përcaktohet se çmimi i shitjes në total është 27.000 euro, duke sqaruar se blerësi e ka paguar të gjithë çmimin jashtë zyrës noteriale, 24.000 euro paguar më datë 03.10.2008 me kalim bankar dhe 3.000 euro janë punime të kryera nga vetë klienti.
31. Për sa i përket deklaratës noteriale nr. {***} rep., datë 29.10.2021, të palëve, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “{***}” ShPK, për interpretimin e kontratës së shitjes, Kolegji vëren se ky akt është paraqitur nga subjekti pas fillimit të hetimit administrativ në Komision. Lidhur me vlerën provuese të deklaratës noteriale për qëllime të procesit të rivlerësimit, Kolegji⁸ në çështje të ndryshme ka mbajtur qëndrim se, megjithëse është e vlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, kjo edhe në

⁸ *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018(JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019(JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019(JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.*

drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve me provat e tjera dhe çdo të dhëna apo informacioni të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ. Edhe në këtë rast, sikundër Kolegji ka analizuar në çështje të ngjashme, fakti që deklaratimet e palëve përputhen plotësisht me shpjegimet e dhëna nga subjekti, për mospërputhjet e rezultuara gjatë hetimit administrativ, krijon bindjen të jenë konceptuar në favor të subjektit.

32. Kolegji konstaton se nga aktet dhe deklaratimet e subjektit rezultojnë të dhëna kontradiktore lidhur me diferencën 3.000 euro në çmimin e blerjes së apartamentit. Ndërsa në deklaratën *vetting* dhe në DPV-në 2012, subjekti ka deklaruar si vlerë 24.000 euro, në kontratën e shitblerjes së datës 27.09.2012, është deklaruar se: *Çmimi i shitjes së pasurisë në total është 27.000 euro ose 3.200.000 lekë. Shitësi deklaron se blerësi ka paguar gjithë çmimin e shitjes jashtë zyrës noteriale, është paguar gjithë vlera, 24.000 euro paguar më 03.10.2008, kalim bankar dhe 3.000 euro janë punime të kryera nga vetë klienti, meqenëse në këtë kontratë është parashikuar detyrimi i pagimit të shumave në lekë.* Subjekti, si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu edhe në ankimin drejtuar Kolegjit, nuk ka pranuar dhe dokumentuar kryerjen e këtyre punimeve, pasi ka pretenduar se kjo shumë është zbritur nga çmimi i shitjes për shkak të mangësive në punime në apartament. Ndërsa në procesverbalin e datës 01.03.2012, në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar lidhur me çmimin e apartamentit se pjesa prej 24.000 eurosh ishte shlyer me kredinë bankare 20.000 euro dhe 4.000 euro me gjendjen e kursimeve të deklaruara para lidhjes kontratës dhe për pjesën 3.000 euro subjekti është shprehur se [...] *do të shlyhet në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare kur të kryhet regjistrimi i apartamentit në regjistrat e pasurive të paluajtshme*⁹.
33. Për sa më sipër, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit arrin të provojë se ka paguar si vlerë të blerjes së apartamentit shumën 24.000 euro, por nuk arrin të provojë se shuma 3.000 euro është zbritur nga çmimi fillestar i dakordësuar për shkak të mangësive në punime dhe nuk është shpenzuar prej tij. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson si të bazuar konkluzionin e Komisionit që ka konsideruar se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për ndryshimin e çmimit të blerjes së apartamentit mbeten në nivel deklarativ dhe se vlera e investimit në blerjen e apartamentit është 27.000 euro.

Për sa i përket mosdeklarimit të burimit për krijimin e pasurisë

34. Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë, si në deklaratën *vetting*, ashtu dhe në deklaratat periodike vjetore. Nga aktet rezulton se subjekti, në deklaratën 2008 dhe në deklaratën *vetting*, ka deklaruar marrjen e kredisë në vlerën 20.000 euro, me qëllim blerjen e apartamentit në {***}. Komisioni është shprehur në vendim se, pavarësisht deklarimit të kredisë si burim për blerjen e apartamentit, subjekti kishte detyrimin të deklaronte edhe burimin e pjesës tjetër të vlerës së blerjes prej 7.000 eurosh. Për këto arsye, Komisioni, në kushtet kur investimin prej 7.000 eurosh e ka konsideruar si jo të justifikuar me të ardhura të ligjshme, e ka cilësuar këtë deklaram si një pasaktësi me peshë specifike që është çmuar si pamjaftueshmëri në deklarimin e subjektit.
35. Në vlerësim të qëndrimit të mbajtur nga Komisioni, subjekti në Kolegji paraqet të njëjtin prapësim, duke pretenduar se në të njëjtën deklaratë periodike ka deklaruar kontratën e kredisë, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë. Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit pretendon se ka

⁹ *Kontrata e shitjes është konkluduar në shtator 2012, disa muaj pas kësaj përgjigjeje që subjekti i ka dërguar ILDKPKI-së në datën 01.03.2012*

deklaruar si burim krijimi të pasurisë vetëm kredinë, por nuk ka deklaruar burim për pjesën tjetër të investimit prej 7.000 eurosh.

36. Nga sa më sipër, Kolegji vëren se pavarësisht se ka deklaruar kredinë si një nga burimet për blerjen e apartamentit, subjekti ka pasur detyrimin e deklarimit të saktë dhe të plotë të burimit të kësaj pasurie, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Për këto arsye, Kolegji e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë. Për sa i përket ligjshmërisë së të ardhurave për investimin e pjesës së mbetur prej 7.000 eurosh, Kolegji do të vlerësojë në vazhdim lidhur me shkaqet e ankimit për deklarimin e gjendjes *cash*.

Lidhur me shlyerjen e kredisë prej 20.000 eurosh

37. Nga aktet rezulton se, sipas kontratës së kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.09.2008, me palë kredidhënës Banka Kombëtare e Greqisë (aktualisht ABI Bank) dhe kredimarrës Ervin Trashi, subjekti ka marrë një kredi në shumën 20.000 euro me qëllim blerje/rikonstruksion apartamenti në {***}, Vlorë, ku pjesëmarrja e kredimarrësit në këtë investim është në shumën 4.000 euro.
38. Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme investimin në total prej 27.000 eurosh, si dhe shlyerjen e kredisë prej 20.000 eurosh.
39. Subjekti ka deklaruar se si burim për shlyerjen pjesërisht të kredisë ka shërbyer huaja e dhënë pa interes në shumën 1.800.000 lekë, të cilën subjekti e ka marrë nga vëllai i tij G. T., me një afat 10-vjeçar, sipas kontratës së huasë (jo noteriale) të datës 25.01.2011, legalizuar nënshkrimet me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.09.2012. Në analizën e tij, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk ka justifikuar burimin e huasë prej 1.800.000 lekësh të dhënë nga vëllai G. T. dhe, për pasojë, nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme depozitimin në *cash* në shumën 15.575 euro, derdhur në datën 28.01.2011, në llogarinë e kredisë në Bankën Kombëtare të Greqisë (ABI Bank).
40. Subjekti në ankim ka prapësuar se Komisioni ka gabuar kur ka konkluduar se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur mundësi të provojë të ardhurat e ligjshme për dhënien e huasë prej 1.800.000 lekësh, pasi:
- është vërtetuar që dhënësi, personi tjetër i lidhur ka kryer punë që gjeneron të ardhura;
 - është vërtetuar që mospagimi i detyrimeve tatimore në kohën e krijimit të të ardhurave ka ardhur nga pakujdesia e personit tjetër të lidhur dhe e punëdhënësit të tij dhe nuk ka pasur për qëllim fshehjen e të ardhurave apo shmangien e ndonjë detyrimi, krijimin e ndonjë përfitimi të paligjshëm për të;
 - është vërtetuar që subjekti i rivlerësimit nuk ka krijuar pasuri me huanë e dhënë, pasi huaja ishte kthyer nga të ardhurat e pagës së subjektit të rivlerësimit, dhe nuk ka përbërë dhuratë, si dhe duhet të kishte përfshirë në analizën e vitit 2011 vlerën e huasë prej 1.800.000 lekësh si të ardhura.
41. Nga aktet në fashikull, Kolegji konstaton se subjekti, në mbështetje të pretendimeve të tij për mundësinë financiare të vëllait për të dhënë hua, ka paraqitur deklaratën noteriale të datës 10.01.2006, me të cilën vëllai i ka dhënë një shtetasi huanë prej 1.200.000 lekësh, si dhe deklarata të disa personave, të cilët kanë deklaruar kryerjen e shërbimeve teknike nga i vëllai gjatë aktivitetit të tij privat në Shqipëri.

42. Në vështrim të provave që subjekti ka paraqitur më sipër, Kolegji çmon se ato nuk mund të kenë vlerë provuese në drejtim të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave për huanë e dhënë subjektit të rivlerësimit. Marrëdhënia e huasë që vëllai ka pasur me një person tjetër, nuk është tregues që ai ka pasur mundësi financiare për t'i dhënë hua 5 vjet më vonë vetë subjektit. Ndërsa deklaratat e personave, që kanë sjellë dëshmi për shërbime të kryera nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, nuk kanë fuqi provuese, si nga përmbajtja, por dhe nga koha kur janë lëshuar, më datë 29.10.2021, pas fillimit të hetimit administrativ ndaj subjektit. Edhe nëse do të pranoheshin deklaratat e mësipërme, për të ardhura të realizuara nga vëllai gjatë aktivitetit privat, këto të ardhura nuk mund të konsiderohen të ligjshme, pasi aktiviteti ka qenë i paregjistruar në organet tatimore, siç e pranon dhe vetë subjekti i rivlerësimit. Paligjshmëria e këtyre të ardhurave, që sipas subjektit kanë shërbyer si burim për huanë, reflektohet dhe në huanë e dhënë subjektit, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye, është i drejtë konkluzioni i Komisionit që nuk e ka konsideruar huanë në shumën prej 1.800.000 lekësh, si burim për shlyerjen e parakohshme totale të kredisë në datën 28.01.2011.

43. Subjekti ka pretenduar se huaja e dhënë nga vëllai nuk ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit dhe se ka pasur mundësi për të shlyer këstin mujor të kredisë që ka qenë afërsisht sa 1/3 e pagës mujore. Huaja, sipas subjektit, është marrë për të zvogëluar shpenzimet e kredisë si ndihmë midis vëllezërish. Kolegji e vlerëson si të pabazuar këtë pretendim të subjektit, pasi pavarësisht se huaja nga vëllai nuk ka shërbyer direkt për blerjen e pasurisë, me të subjekti ka justifikuar shlyerjen e kredisë me të cilën është bërë blerja e apartamentit. Përderisa subjekti është i lidhur me këtë marrëdhënie huaje me vëllain, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit 84/2016, atëherë edhe huaja nga vëllai do t'i nënshtrohet verifikimit të ligjshmërisë dhe mjaftueshmërisë së burimeve të krijimit të saj, në kuadër të analizës financiare për mbulimin e shpenzimeve për shlyerjen e saj.

43.1. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit se vlera huasë është llogaritur dy herë, pasi Komisioni, megjithëse nuk e ka konsideruar huanë si burim të ligjshëm, e ka ngarkuar me shlyerjen e kësaj huaje në vitet 2011-2015, Kolegji vlerëson se kontrolli i ligjshmërisë së burimeve të huave bëhet në funksion të kontrollit të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në momentin e blerjes së saj, kurse analiza financiare e shpenzimeve ka si qëllim të verifikojë nëse shpenzimet e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike në vitet pasuese janë përballuar ose jo me burime të ligjshme. Në këtë rast problematikat nuk trajtohen si të mbivendosura me njëra-tjetrën, por analizohen nga dy optika krejt të ndryshme, në funksion të qëllimit për të vlerësuar në mënyrë të gjithanshme besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë¹⁰.

44. Në përfundim të sa më sipër, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë si të krijuar me të ardhura të ligjshme huadhënien e vëllait, në kuptim të pikës 3, të nenit D të ligjit nr. 84/2016 dhe shuma prej 1.800.000 lekësh nuk konsiderohet si burim i ligjshëm për shlyerjen e parakohshme të kredisë në NBG në datën 28.01.2011.

Lidhur me likuiditetin cash prej 400.000 lekësh deklaruar në DPF, që ka shërbyer për pagesën e shumës 4.000 euro për apartamentin

45. Subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës, dorëzuar në tetor 2007, ka deklaruar *cash* shumën prej 400.000 lekësh, e cila, sipas tij, është përdorur në vitin 2008, për pagesën e shumës 4.000 euro, për blerjen e apartamentit në {***}. Subjekti parashtron në ankim se pavarësisht pasaktësisë

¹⁰ Shih vendimin e Kolegjit nr. 47/2022(JR) prg. 23.8.

në deklaratën periodike të vitit 2008, kjo shumë rrjedh nga burime të ligjshme që janë të ardhurat e bursës së Shkollës së Magjistraturës. Lidhur me mosdeklarimin e kësaj shume dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti shprehet se ka vlerësuar se në deklaratën periodike deklarohen ndryshimet e pasurisë dhe kjo shumë nuk kishte ndryshuar.

46. Komisioni, lidhur me deklaratimet e subjektit për shumën 400.000 lekë, ka konkluduar se: (i) subjekti nuk ka deklaruar as gjendje, as ndryshime të gjendjes cash në DPV/2007, duke lënë të kuptohet se gjendja cash është 0 (zero); (ii) subjekti nuk e ka deklaruar përdorimin e kësaj shume cash në DPV/2008; (iii) nga deklaratimet e gjendjes cash ndër vite është konkluduar se subjekti ka deklaruar gjendje dhe jo shtesa të gjendjes cash, [...], e kështu, sipas deklaratimit të vitit 2007 gjendja cash prezumohet të jetë 0 (zero).
47. Në përfundim, Komisioni shumën cash prej 400.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, nuk e ka konsideruar si burim për krijimin e shumës 4.000 euro, të depozituar në NBG në datën 01.10.2008, duke u konsideruar si e shpenzuar brenda vitit 2007. Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësinë e krijimit të vlerës 4.000 euro më 01.10.2008, me të ardhurat e vitit dhe i ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, për shkak të një balance negative prej 1.436.724 lekësh.
48. Lidhur më sa më sipër, në vlerësimin e këtij shkak ankimi, Kolegji vëren se duhen pasur në konsideratë dy momente, saktësia në deklaratime, si dhe mjaftueshmëria e të ardhurave të subjektit, për të krijuar me burime të ligjshme depozitimin cash prej 4.000 eurosh.
49. Për sa i takon saktësisë në deklaratat vjetore, si dhe në deklaratën *vetting*, konstatohet se subjekti e ka deklaruar gjendjen cash në deklaratën para fillimit të detyrës, në tetor 2007, por nuk e ka deklaruar në deklaratat periodike 2007 dhe 2008, as gjendje dhe as pakësim të cash-it, si dhe as përdorimin e kësaj shume në vitin 2008. Ndërsa në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin për blerjen e apartamentit, për rrjedhojë nuk ka as deklarim të gjendjes cash të përdorur, sipas subjektit, për blerjen e apartamentit. Nga sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me deklarimin e cash-it, deduktohet se në deklaratat periodike vjetore në vite ai ka deklaruar gjendjen e cash-it dhe jo ndryshimet e tij. Për sa më sipër, Kolegji e gjen të pabazuar në fakte pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për pagesën e kësaj prej 4.000 eurosh ka përdorur gjendjen cash të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, sa kohë ky pretendim mbetet i paprovuar.
50. Për sa i përket mundësisë financiare të subjektit për të krijuar likuiditetin për depozitimin cash prej 4.000 eurosh, Kolegji, pas verifikimit të analizës financiare të kryer në Komision, konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shkak të një balance negative prej (-) 1.297.702 lekësh¹¹.

¹¹ Konstatohet se në Komision për periudhën 01.01-01.10.2008 është kryer analizë vetëm me të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë në analizën totale të viteve, nga 05.10.2007-31.12.2016, të vit pas viti, Komisioni, në analizën financiare, në raportin e rezultateve hetimore ka konsideruar dhe të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve, ashtu ka vepruar dhe në rishikimin e analizës financiare pas prapësimeve të rezultateve hetimore, të cilën e ka reflektuar në përfundim dhe në vendim. Pra, në vlerësimin e mundësisë për depozitimin/kursimin me të ardhurat e vitit të vlerës 4.000 euro në ish-NBG, Komisioni duhet të kishte konsideruar në analizë dhe të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe shpenzimet e jetesës respektive. Të ardhurat e prindërve do të ishin 306.452 lekë (total i të ardhura nga paga e babait prej 126.311 lekësh, sipas lëvizjeve të llogarisë së pagës në "Raiffeisen Bank" dhe të ardhura nga paga e nënës prej 180.141 lekësh, sipas lëvizjeve të llogarisë së pagës në "Raiffeisen Bank"), si dhe rillojaritjen e shpenzimeve të jetesës përpjesëtimore për 9 muaj për subjektin dhe prindërit, sipas analizës totale të

51. Në konkluzion, Kolegji vlerëson si të bazuar qëndrimin e mbajtur nga Komisioni se shuma *cash* prej 400.000 lekësh nuk duhet konsideruar si burim për krijimin e likuiditetit prej 4.000 eurosh të depozituar në NBG në datën 01.10.2008, por si e shpenzuar brenda vitit 2007.

Lidhur me investimin në apartament, në vlerën 3.000 euro

52. Referuar procesverbalit të ILDKPKI-së, datë 01.03.2012, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka deklaruar lidhur me çmimin e apartamentit se pjesa prej 24.000 eurosh ishte shlyer me kredinë bankare 20.000 euro dhe 4.000 euro me gjendjen e kursimeve të deklaruara para lidhjes kontratës e ndërsa për pjesën 3.000 euro subjekti është shprehur se [...] *do të shlyhet në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare, kur të kryhet regjistrimi i apartamentit në regjistrat e pasurive të paluajtshme*. Lidhur me këtë shumë, subjekti, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka mbajtur qëndrimin se nuk është paguar prej tij dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 sqaron në pyetjen nr. 1, se nuk ka kryer punime ekstra, por se ka paguar vetëm 24.000 euro dhe se *nga ana ime nuk janë kryer punime ndërtimi në apartamentin e marrë në dorëzim nga shoqëria ndërtuese. Ai apartament vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite në kushtet e dorëzimit të tij*.

53. Referuar kontratës së shitblerjes të datës 27.9.2012 çmimi është dhënë 27.000 euro ose 3.200.000 lekë e konfirmon pagesën 24.000 euro dhe, më tej, shprehet se [...] *3.000 euro janë punime të kryera nga vetë klienti. Meqenëse në këtë kontratë është parashikuar detyrimi i pagimit të shumave në lekë*.

54. Ashtu si është argumentuar dhe konkluduar në paragrafët 33 dhe 34 të këtij vendimi, subjekti nuk arrin të provojë se çmimi i blerjes së apartamentit ka qenë 24.000 euro, si dhe nuk ka provuar se shuma 3.000 euro është zbritur nga çmimi i shitjes, për shkak të mangësive në punime në apartament dhe, për këtë arsye, kjo shumë konsiderohet si pjesë e investimit total të kryer, për të cilën subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin e burimit në deklaratën *vetting*.

55. Sa më sipër, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të justifikojë me të ardhura të ligjshme investimin prej 7.000 eurosh për blerjen e apartamentit, në kushtet kur nuk arrin të provojë krijimin e likuiditeteve për pagesën e kështit prej 4.000 eurosh, si dhe zbritjen e shumës 3.000 euro nga çmimi i blerjes së apartamentit. Kolegji, ashtu si dhe Komisioni, konkludon se investimi i kryer prej 3.000 eurosh është përfshirë si shpenzim i ndarë në vitet 2010-2012, vite të cilat kanë rezultuar me balanca negative, pra, me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara¹².

Komisionit në vendim (paragrafi 91) prej 269.895 lekësh (total shpenzimet e vitit 2008 prej 359.860 lekë /12 muaj x 9 muaj), e do të ndryshonte diferencën negative (ulur prej 139.022 lekë) për periudhën në analizë 01.01.2008-01.10.2008, por jo duke e zhbërë këtë diferencë negative, pra, me pamundësi për krijimin e kursimit për depozitim e vlerës 4.000 euro dhe përbalimin e shpenzimeve familjare me burime të ligjshme.

¹² *Duke konsideruar rishikimin e shpenzimeve të transportit nga ato të konsideruara nga Komisioni prej 169.400 lekësh në vitet 2011 e 2012, në 154.700 lekë, sipas subjektit të rivlerësimit (trajtuar në vijim) në vitin 2012 e në vitin 2011 konstatohet se Komisioni nuk duhet të kishte përlllogaritur shpenzime transporti për vitin 2011 si total viti (prej 169.400 lekësh), pasi në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka punuar dhe jetuar me qira në Gjirokastrë deri më 14.11.2011, pra, shpenzimet e transportit për Lushnjë – Vlorë – Lushnjë duhet të ishin llogaritur vetëm për pjesën e mbetur të vitit 15.11.2011 – 31.12.2011, ashtu si ka pretenduar dhe subjekti në përgjigje të rezultateve hetimore dhe në ankim në analizën e vitit 2011, pra, shpenzimet e transportit do të ishin 14.000 lekë [llogaritur si 700 lekë dita x 5 ditë pune x 4 javë punë (duke e rumbullakosur e konsideruar fundin e vitit që janë festat) = 14.000 lekë.] 4 javë x 5 ditë punë, por sërish balancat negative nuk do të zhbëheshin edhe pse do uleshin, në vlerën prej (-) 2.123.341 lekë në vitin 2011 e (-) 384.310 lekë në vitin 2012. Ndërsa për analizën e vitit 2010 konfirmohet rezultati i Komisionit për një balancë negative prej (-)315.463 lekësh.*

56. Në përfundim, për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 56 m², ndodhur në {***}, Vlorë, Kolegji konsideroi se subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarime të pasakta në deklaratën *vetting* për burimin e krijimit të pasurisë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” të ligjit nr. 84/2016, si dhe është në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie¹³, të cilat e vendosin në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të këtij ligji.
- ii) Lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë me kontratën nr. {***}, datë 27.12.2016*
57. Sa i takon shkakut të ankimit, lidhur me kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të arritur nga ana e Komisionit për pasaktësi në deklarim si rrjedhojë e mosdeklarimit në deklaratën *vetting* të burimit të krijimit të kësaj pasurie, si dhe për mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2016, Kolegji konstatoi si më poshtë.
58. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni në vendimin e tij, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arsyetuar se: *Në rastin e subjektit Ervin Trashi, në përfundim të hetimeve, Komisioni evidentoi fakte dhe rrethana që tregojnë se ai është sjellë në mënyrë të vazhdueshme si pronar i mjetit që në momentin e blerjes nga shtetasi Z. B. në vitin 2012 derisa mjeti u ble prej tij në vitin 2016 dhe, për rrjedhojë, ka pasur dyshime të arsyeshme që mjeti mund të jetë blerë prej tij që në vitin 2012, duke ngritur hipoteza për një pasuri të fshehur të subjektit. Edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk arriti të kundërshtojë bindshëm faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë hetimit administrative [...]. Komisioni kreu analizën financiare në variantin e paraqitur nga subjekti dhe çmoi të konsiderojë pretendimet e tij në lidhje me vlerën e blerjes së mjetit në një qasje garantiste, duke iu referuar çmimit të blerjes së pasurisë prej 600.000 lekësh, të përcaktuar në kontratën e shitjes së pasurisë të vitit 2016, dhe jo deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sipas së cilit vlera e blerjes së mjetit në vitin 2010 ka qenë 13.000 euro. Sipas kësaj analize, subjekti nuk ka pasur mjaftueshmëri të ardhura të ligjshme për blerjen e mjetit në vitin 2016, për shkak të një balance negative prej - 433.048 lekësh [...]. Në procesin e vlerësimit përfundimtar, balancat negative të rezultuara dhe qëndrimet e subjektit në lidhje me dyshimet e ngritura për një pasuri të blerë prej tij që në vitin 2012, janë konsideruar si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.*
59. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuara konkluzionet e Komisionit duke pretenduar se: (i) mosdeklarimi i burimit në deklaratën *vetting* ka qenë një lapsus dhe nuk mund të interpretohet si i qëllimshëm, pasi nuk ka pasoja konkrete sa kohë nuk ka shërbyer si mjet për të fshehur pasurinë apo pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj; (ii) për shkak të marrëdhënieve familjare dhe shoqërore e ka përdorur automjetin njëkohësisht me pronarin e tij, dhe se nuk e ka fshehur përdorimin, pasi e ka deklaruar me aktin noterial nr. {***} rep., datë 18.10.2012; (iii) rezultati financiar në vitin 2016 duhet të jetë pozitiv, pasi Komisioni ka llogaritur gabim shpenzimet e transportit, shpenzimet e udhëtimeve, si dhe shpenzimet jetike.
60. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, Kolegji konstaton se gjatë hetimit administrativ të Komisionit, referuar akteve të vëna në dispozicion nga DPSHTRr-ja, rezulton se automjeti tip “Mercedes-Benz” është blerë nga shtetasi Z. B. (burri i tezes së subjektit të rivlerësimit), me kontratën e shitjes së datës 17.09.2012, në vlerën 600.000 lekë. Sipas certifikatës së pronësisë, datë

¹³ Sipas analizës në paragrafët 51 dhe 56 të këtij vendimi.

24.09.2012, automjeti është regjistruar në pronësi të shtetasit Z. B. dhe dy ditë më vonë, në datën 26.09.2012, automjeti është pajisur me TPL, ku figuron si i siguruar shtetasi Ervin Trashi dhe përfitues Z. B.. Me deklaratën noteriale nr. {***}, datë 18.10.2012, shtetasi Z. B. i ka dhënë automjetin në përdorim subjektit të rivlerësimit pa afat dhe pa kundërshpërblim. Me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. {***}, datë 05.02.2016, shtetasi Z. B. i ka shitur shtetasit A. L. këtë automjet, me çmimin 800.000 lekë. Nga të dhënat në sistemin e AMF-së nuk rezulton asnjë policë sigurimi në emër të shtetasit A. L. gjatë periudhës që e ka pasur në pronësi këtë automjet, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit figuron si pronar i automjetit në policën e sigurimit. Me prokurën e posaçme nr. {***}, datë 26.02.2016¹⁴, shtetasi A. L. ka emëruar si përfaqësues të posaçëm subjektin e rivlerësimit, të cilit i ka dhënë të drejtë ta përdorë, administrojë, të nënshkruajë kontrata qiraje, huapërdorjeje dhe kontratë shitjeje, për automjetin për një periudhë pa afat. Me kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 27.12.2016, shtetasi A. L. i ka shitur subjektit Ervin Trashi automjetin në çmimin 600.000 lekë, shumë e cila është paguar para përpilimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale.

61. Kolegji konstaton se nga hetimi në Komision i të dhënave në sistemin *TIMS*, rezulton se automjeti është përdorur disa herë nga subjekti i rivlerësimit për kalimin e kufirit gjatë kohës që ka qenë në pronësi të dy blerësve të parë Z. B. dhe A. L.. Gjithashtu, në dokumentacionin e administruar në dosjen e Komisionit, nga policat e sigurimit të detyrueshëm për qarkullim brenda territorit të Shqipërisë që i përkasin këtij mjeti, të nxjerra nga sistemi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, figuron si përdorues subjekti i rivlerësimit për periudhën kur nuk e ka pasur në pronësi këtë automjet.
62. Në analizë të dokumentacionit të sipërcituar, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit për periudhën 2012-2016 e ka pasur në përdorim të vazhdueshëm këtë automjet, ndërkohë që nuk ka të dhëna të përdorimit të tij nga pronarët formalë të automjetit, shtetasit Z. B. dhe A. L.. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson të bazuar konkluzionin e Komisionit se pavarësisht se mjeti *de jure* nuk është blerë nga subjekti që në vitin 2012, duket se ai e ka blerë *de facto* në këtë vit.
63. Pavarësisht qëndrimit për sjelljen e subjektit të rivlerësimit si pronar i këtij automjeti para blerjes së tij, Komisioni, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, ka çmuar të konsiderojë pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerën e blerjes së mjetit në një qasje garantiste, duke iu referuar çmimit të blerjes së pasurisë prej 600.000 lekësh të përcaktuar në kontratën e shitjes së pasurisë të vitit 2016 dhe ka konkluduar se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për blerjen e mjetit. Lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, subjekti i rivlerësimit mban qëndrim të kundërt duke parashtruar se në vitin 2016 ka pasur mundësi që me kursimet e tij të blejë këtë automjet. Sipas subjektit, rezultati financiar në vitin 2016 duhet të jetë pozitiv, pasi janë llogaritur gabim shpenzimet e transportit, shpenzimet e udhëtimeve, si dhe shpenzimet jetike.
64. Sipas analizës së kryer në Komision, lidhur me blerjen e automjetit në vitin 2016 në vlerën prej 600.000 lekësh, pas rishikimit të analizën në përgjigje të rezultateve hetimore, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2016, për shkak të një balance negative në analizën e vitit 2016 prej (-) 433.048 lekësh. Gjithashtu dhe

¹⁴ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 08.05.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me Regjistrin Elektronik të Noterëve.

Kolegjit i rezulton pamjaftueshmëri të ardhurash të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2016¹⁵, në vlerën prej (-) 418.348 lekësh.

65. Kolegji konstaton se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se *në vendim nuk ka analizë financiare e ndodhet në pamundësi për ta kundërshtuar, si dhe pretendimit se nga një llogaritje e thjeshtë konkluzioni është i gabuar, e sipas përlllogaritjeve diferenca duhet të ishte (-) 483.048 lekë*, pasi rezulton se Komisioni në vendim nuk ka paraqitur analizë tabelare të detajuar, por lidhur me analizën financiare ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur në paragrafin 91 të vendimit, analizën e vitit 2016, si rezultat me totalin e elementëve të analizës “Pasuri”, “Detyrime”, “Pasuri Neto (1-2)”, “Të Ardhura”, “Shpenzime” dhe “Mundësia për kursime (4-5-3)”. Për sa i përket analizës së vitit 2016 në raportin e rezultateve hetimore, subjektit i është dhënë analiza e detajuar financiare e vitit 2016 në formë tabelle, e sipas arsytimit në vendimin e Komisionit, si dhe në metodologjinë e shpjeguar në vijim, është sqaruar se automjeti me vlerën 600.000 lekë do konsiderohet si pasuri e vendosur në vitin 2016, duke rritur vlerën e elementit “Pasuri” në analizën e vitit, e cila është pasqyruar te totali i këtij elementi, në paragrafin 91 të vendimit¹⁶, paraqitur si tabelë. Në vendim, Komisioni është shprehur lidhur me elementët e tjerë të analizës së vitit për sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet e rezultateve hetimore, ku është arsyetuar se janë konsideruar në analizë rishikimi i shpenzimeve të jetesës për shkak të përdorimit të produkteve nga toka bujqësore prej 50.000 lekësh, pra, duke ulur vlerën e elementit “Shpenzime” në analizën e vitit, e cila është pasqyruar te totali i këtij elementi në paragrafin 91 në vendimin e Komisionit¹⁷, paraqitur si tabelë, ndërsa elementët e tjerë në analizë kanë qëndruar të pandryshuar “Detyrime”, “Pasuri Neto (1-2)”, “Të Ardhura”. Këto ndryshime në elementët e analizës së vitit si total “Pasuri” (shtuar me + 600.000 lekë) dhe “Shpenzime” (pakësuar me -50.000 lekë) kanë rezultuar në ndryshimin e rezultatit të vitit “Mundësia për kursime (4-5-3)” nga +116.952 lekë në analizën në rezultatet hetimore, me (-) 433.048 lekë në analizën përfundimtare.
66. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në drejtim të deklarimit të burimit të krijimit të kësaj pasurie, Kolegji konstaton nga aktet se në deklaratën *vetting* subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë, ndërsa në DPV-në për vitin 2016 ka deklaruar si burim kursimet nga pagat e viteve 2015 dhe 2016. Subjekti pretendon në ankim, ashtu si dhe ka parashtruar dhe në Komision, se mosdeklarimi i burimit në deklaratën *vetting*, që ka ardhur si pasojë e një lapsusi, nuk mund të interpretohet si e qëllimshme nga ana e subjektit, sa kohë nuk provohet se kjo situatë ka shërbyer si mjet për të fshehur pasurinë apo pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji çmon se mungesa e deklarimit të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting* e bën deklarinimin e subjektit të rivlerësimit në këtë deklaratë të paplotë e të pasaktë dhe vjen në kundërshtim me përcaktimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Kolegji, në vlerësim të këtij pretendimi, i bashkohet qëndrimit të Komisionit se në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arrin të vërtetojë pasjen e burimeve të ligjshme për blerjen e këtij automjeti, si dhe bazuar në një vlerësim tërësor të rrethanave të lidhura me përdorimin e këtij automjeti, mosdeklarimi i burimit merr një peshë specifike të posaçme, duke

¹⁵ Duke konsideruar rishikimin e shpenzimeve të transportit nga ato të konsideruara nga Komisioni prej 169.400 lekësh në 154.700 lekë, sipas subjektit të rivlerësimit (trajtuar në vijim), sërish balanca negative nuk do të zhbëhej dhe pse do ulej për diferencën prej 14.700 lekësh, pra, në vlerën prej (-) 418.348 lekësh.

¹⁶ Nga tabela në rezultatet hetimore “Pasuri” prej 996.782 lekësh në tabelën në vendim parag. 91 “Pasuri” prej 1.596.782 lekësh, pra, + 600.000 lekë.

¹⁷ Nga tabela në rezultatet hetimore “Shpenzime” prej 1.007.020 lekësh në tabelën në vendim parag. 91 “Shpenzime” prej 957.020 lekësh, pra, (-) 50.000 lekë.

e kualifikuar këtë situatë faktike si deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe bëhet shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

67. Në përfundim, për automjetin tip “Mercedes-Benz”, sipas kontratës së blerjes, datë 27.12.2016, trupi gjykues i Kolegjit mban të njëjtin qëndrim në arsyetim si Komisioni se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- iii) *Lidhur me automjetin tip “Nissan Primera”, blerë me kontratën e blerjes nr. {***}, datë 15.10.2007*
68. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se, meqenëse të ardhurat për blerjen janë dhuratë nga prindërit dhe janë krijuar prej tyre para fillimit të detyrës së subjektit (automjeti është blerë më 15.10.2007 ose 10 ditë pas emërimit në detyrë të tij dhe është deklaruar në DPV-në e vitit 2007 me burim të ardhura nga prindërit), mungesa e fondeve për blerjen e automjetit nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit. Në lidhje me shitjen e këtij automjeti në vitin 2009, në shumën 300.000 lekë, sipas Komisionit, subjekti nuk ka provuar se ka paguar tatim mbi fitimin e krijuar nga shitja e automjetit dhe, për këtë shkak, si e ardhur nga shitja duhet të konsiderohet shuma 200.000 lekë, ashtu sikurse ishte konsideruar në analizën e dërguar me rezultatet e hetimit administrativ.
69. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit, duke pretenduar se nga interpretimi i të gjitha parashikimeve ligjore për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e automjeteve rezulton se e ardhura e përfitur si fitim midis çmimit të shitjes dhe të blerjes së automjeteve nuk është e ardhur e tatueshme dhe në legjislacionin e kohës nuk ka pasur procedurë të përcaktuar për mbledhjen e këtij tatimi dhe, në këto kushte, ai nuk ka pasur detyrim ligjor për pagesën e ndonjë detyrimi tatimor për këtë të ardhur.
70. Nga aktet në dokumentacionin e Komisionit, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***}, datë 15.10.2007, ka blerë nga shtetasi L. Y. automjetin tip “Nissan”, me targa {***}, në shumën 200.000 lekë. Subjekti e ka deklaruar blerjen e automjetit në DPV-në e vitit 2007. Sipas kontratës së shitblerjes nr. {***}, datë 19.03.2008, subjekti i rivlerësimit i ka shitur automjetin shtetasit T. M. në shumën 300.000 lekë. Subjekti e ka deklaruar shitjen e automjetit në shumën 300.000 lekë, në DPV-në e vitit 2008.
71. Kolegji vëren se në rastin konkret, ashtu si dhe është shprehur subjekti i rivlerësimit në ankim, legjislacioni tatimor ka qenë i paqartë nëse të ardhurat nga shitja e automjetit ishin të ardhura të tatueshme, si dhe për procedurën si do të kryhej pagesa e detyrimeve tatimore. Nga dispozitat e ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, konkretisht të nenit 8 të tij në të cilin listohen të ardhurat e tatueshme, nuk rezulton që të ketë një parashikim të qartë për të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurive të luajtshme, ku përfshihen dhe automjetet. Kjo paqartësi e dispozitës ka sjellë si pasojë mosveprimin e subjektit të rivlerësimit për pagesën e tatimit në kohën e krijimit të të ardhurave nga shitja. Në këndvështrim të këtyre parashikimeve ligjore, të cilat nuk rezultojnë të kenë një parashikim eksplisit për detyrimin tatimor që lind në raste të tilla, duke mbajtur në konsideratë dhe peshën e shumës prej 100.000 lekësh, të rezultuar nga diferenca e çmimit të shitjes me çmimin e blerjes së automjetit, në vlerësimin e pasurisë dhe problematikave të çështjes, Kolegji vlerësoi pa ndikim në vendimmarrje konsiderimin ose jo si të ardhur të ligjshme të kësaj shume, në cilindo version që ajo do të kualifikohej, dhe për këtë arsye e gjeti të panevojshëm trajtimin më tej të këtij shkakut ankimi.

*iv) Lidhur me shtëpinë e banimit, adresa: lagja “{***}”, rruga “H. S.”, Lushnjë, në pronësi të prindërve*

72. Në procesin e vlerësimit përfundimtar për këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës në lidhje me ndërtimin e katit të tretë/papafingo gjatë kohës që ka qenë në detyrë. Për këtë pasuri, për të cilën mungon të jenë kryer deklarime si pasuri në përdorim në deklaratën *vetting*, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon detyrimin e subjekteve që të deklarojnë edhe të drejtat reale të pasurive në përdorim, vlerën dhe burimin e krijimit të tyre, (ndonëse është deklaruar si adresë banimi), subjekti ka kryer deklarime të pasakta dhe kontradiktore, si dhe nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme ndërtimin e katit të tretë papafingo gjatë periudhës që ka qenë në detyrë. Për rrjedhojë, ka kryer deklarime të pamjaftueshme, të cilat, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
73. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit se ka kryer deklarime të pasakta dhe kontradiktore, si dhe nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme ndërtimin e katit të tretë papafingo gjatë periudhës që ka qenë në detyrë, pasi subjekti nuk është bashkëpronar dhe nuk ka kontribuar në pasuritë e prindërve. Subjekti parashtron se kjo shtëpi është ndërtuar para se të fillonte punën si gjyqtar dhe nuk duhet të përfshihet në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, pasi në këtë shtëpi ai ka vetëm të drejta banimi. Pasaktësitë në mosdeklarimin e sipërfaqes dhe vlerës nuk kanë të bëjnë me fshehjen e kësaj pasurie, pasi bashkë me deklaratën *vetting* janë dorëzuar edhe aktet zyrtare të legalizimit të kësaj pasurie të pranuar nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit parashtron se personat e lidhur, prindërit, janë hetuar vetëm për shkak të qenies në të njëjtën certifikatë të gjendjes civile me subjektin, ndërkohë që nuk ka asnjë marrëdhënie financiare midis tij dhe prindërve.
74. Nga verifikimi i akteve në dokumentacionin e Komisionit, për këtë pasuri, Kolegji konstaton se në deklaratën *vetting*, personat e lidhur, babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit, kanë deklaruar: *Shtëpi banimi nr. pasurie {***}, z. k. {***}, sip. 220 m². Numri i kateve 3. Adresa lagja “{***}”, rruga “{***}”, Lushnjë. Kjo banesë është ndërtuar para vitit 2006, vërtetuar nga formulari i vetëdeklarimit të legalizimit të objektit, datë 06.09.2006, pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore Lushnjë. Me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.01.2013, ka kaluar në pronësi parcela ndërtimore. Objekti është legalizuar me lejen e legalizimit nr. {***}, datë 31.01.2013, lëshuar nga ALUIZNI Dega Lushnjë. Pjesa takuese: 50 me 50%. Nuk është deklaruar burimi dhe vlera e pasurisë.*
75. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vendbanim dhe adresë regjistrimi në gjendjen civile shtëpinë e banimit në fjalë, si në deklaratën *vetting*, ashtu dhe në gjithë deklaratat periodike vjetore 2007-2017.
76. Në dosjen e ILDKPKI-së është administruar procesverbal-konstatimi nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI Qarku Fier, i datës 05.01.2009, sipas të cilit rezulton se ndërtesa ka 3 kate me sipërfaqe të përgjithshme 554,6 m².
77. Nga dokumentacioni i Komisionit,¹⁸ sipas lejes së legalizimit nr. {***}, datë 31.01.2013, rezulton godinë banimi 3 kate, në emër të A. H. T., Lushnjë, nr. pasurisë {***}, sipërfaqe e parcelës 220,8 m², sipërfaqja e ndërtimit 162,5 m², sipërfaqe totale 554,6 m². Sipas vërtetimit nga dokumentet

¹⁸ Shkresa nr. {***} prot., datë 28.08.2017, e ALUIZNI-t Lushnjë, dërguar ILDKPKI-së.

hipotekore, datë 22.02.2013, vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 22.02.13, figuron në pronësi të A. H. T., pasuria nr. {***}, me sip. 220,8 m², në adresën e llojit truall+ndërtesë (shtëpi banimi 3 kate: kati përdhe = 162,5 m², sip. kati i parë =194,5 m², sip. kati i dytë =197.6 m²).

78. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, fillimisht Kolegji vlerëson si të pabazuar në ligj kundërshtimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me hetimin nga Komisioni të prindërve si persona të lidhur. Kolegji vëren se prindërit e subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 13, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konsiderohen si persona të lidhur, pasi në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting* subjekti ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit. Për këtë arsye, pavarësisht pretendimeve të subjektit, prindërit e tij, si persona të lidhur për shkak të ligjit, duhet të deklaronin saktësisht interesat pasurorë dhe kryerja nga Komisioni i verifikimit të deklarimeve të tyre është brenda objektit të procesit të rivlerësimit.
79. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për konkluzion të gabuar të Komisionit, sipas të cilit subjekti duhet ta kishte deklaruar si pasuri në përdorim në deklaratën *vetting*, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit në vazhdimësi, në deklaratën *vetting*, si dhe në të gjitha deklaratat periodike vjetore në vitet 2007-2017, e ka deklaruar shtëpinë si adresë banimi. Kolegji çmon se pavarësisht detyrimit të deklarimit të përdorimit në deklaratën *vetting*, në kushtet ku nuk mund të konsiderohet se ka pasur tentativa për fshehje të kësaj pasurie, për më tepër që ai nuk ka qenë bashkëpronar, pasi pronësia e shtëpisë ka qenë që në fillim e babait të tij dhe subjekti i rivlerësimit ka banuar dhe vazhdon të banojë në shtëpinë në fjalë, që prej fëmijërisë së tij, vetëm kjo pasaktësi në deklaram nuk mund të përbënte një shkak të vetëm për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit.
80. Lidhur me kohën e përfundimit të katit të tretë të shtëpisë së banimit, Kolegji konstaton se rezulton e provuar që kati i tretë është përfunduar pas datës 14.04.2007, sipas datës së fotografimit satelitor nga të dhënat e Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor, nga i cili duket qartë se ndërtesa në këtë datë nuk e ka pasur çatinë e pjerrët. Nga informacioni i sjellë nga ky institucion, sipas kuotave mbi lartësinë e objektit, rezulton se lartësia e banesës në vitin 2007 ka qenë më e ulët se ajo e vitit 2015.¹⁹ Fakti i ndërtimit të katit të tretë pas datës 14.04.2007 është pranuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës në Komision, në ndryshim nga sa kishte deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, se kati i tretë/papafingoja ka përfunduar rreth viteve 2005-2006. Kolegji konstaton se këto deklarime të subjektit të rivlerësimit janë kontradiktore dhe me deklarin e bërë nga personi i lidhur, babai, i cili në deklaratën *vetting* ka deklaruar se *kjo banesë është ndërtuar para vitit 2006, vërtetuar nga formulari i vetëdeklarimit të legalizimit të objektit, datë 06.09.2006, pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore Lushnjë*, ndërkohë që në formularin e vetëdeklarimit të legalizimit prej tij është deklaruar *viti i ndërtimit 10.09.2000*.
81. Referuar informacionit të dhënë nga Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor, procesverbal-konstatimit nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI Qarku Fier, të datës 05.01.2009, si dhe deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, Kolegji çmon se qëndron konkluzioni i Komisionit se kati i tretë konsiderohet të jetë ndërtuar nga data 14.04.2007, që është

¹⁹ Shkresat nr. {***} prot., datë 14.09.2021 dhe nr. {***} prot., datë 22.09.2021, të Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor, në dosjen e Komisionit.

data e fotografimit satelitor, deri më 05.01.2009, të datës së procesverbal-konstatimit, ku rezulton se ndërtesa ka 3 kate të përfunduara.

82. Në mbështetje të pretendimit të tij për kohën e përfundimit të katit të tretë të banesës para datës së fillimit të detyrës më 05.10.2007, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë shkresore në Komision deklaratën me vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., datë 28.10.2021, të shtetasit M. H., i regjistruar si person fizik në fushën e ndërtimit, i cili deklaron se është kontraktuar në gusht të vitit 2007 për ndërtimin e çatisë, e cila ka përfunduar brenda këtij muaji. Bashkëngjitur kësaj deklaratë është depozituar dhe një faturë e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 02.08.2007, sipas së cilës rezultojnë punime për ndërtim çatie kati III, materiale + punëtor, me sip. 170 m², në total në shumën 510.000 lekë.
83. Kolegji vëren se provat e mësipërme të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të vërtetuar që kati i tretë ka përfunduar para se ai të fillonte detyrën si gjyqtar, nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni, i cili edhe për shkak të momentit kur i ka paraqitur subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, i ka konsideruar si përpjekje e subjektit për të justifikuar përfundimin e katit të tretë para fillimit të detyrës. Lidhur me qëndrimin e Komisionit se subjekti i ka paraqitur provat pas kalimit të barrës së provës, Kolegji çmon se ky fakt nuk duhet ta penalizojë subjektin e rivlerësimit, pasi duke pasur parasysh procesin e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit vetëm pasi njihet me rezultatet e hetimit dhe i kalon barra e provës ka mundësinë që të plotësojë mbrojtjen e tij, duke paraqitur dhe provat përkatëse që u korrespondojnë gjetjeve të Komisionit. Por, Kolegji vëren se pavarësisht momentit të dorëzimit të deklaratës dhe të faturës së lëshuar nga personi fizik, subjekti nuk arrin të justifikojë me këto dokumente përfundimin e katit të tretë papafingo brenda periudhës nga data 14.04.2007, që është data e fotografimit satelitor, deri në datën 05.10.2007, që është data e emërimit të subjektit në detyrë, pra, jashtë periudhës që ai ka qenë në detyrë. Deklarata noteriale e dhënë në kohën kur ndaj subjektit të rivlerësimit kishte filluar procesi i rivlerësimit, në kushtet kur nuk mbështetet nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit, krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit
84. Në përfundim, lidhur me periudhën e ndërtimit të katit të tretë të banesës, Kolegji arrin në konkluzionin se pretendimet e subjektit nuk u mbështetën nga rrethanat e rezultuara, sipas dokumenteve të administruara dhe as nga provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, duke mos arritur të provonte se ky ndërtim ishte bërë para fillimit të detyrës prej tij.
85. Komisioni ka konkluduar për mungesë të justifikimit me të ardhura të ligjshme për ndërtimin e katit të tretë, për shkak të një balance negative lidhur me analizën e periudhës 05.10.2007-31.12.2007 dhe të vitit 2008. Sipas analizës përfundimtare, Komisioni, pas përgjigjeve të rezultateve hetimore, i referohet një vlere prej (-) 2.278.107 lekësh [si total i analizës së periudhës 05.10.2007-31.12.2007, me diferencë prej (-) 629.771 lekësh dhe analizës së vitit 2008 me rezultat prej - 1.648.336 lekësh]. Referuar rishikimit të analizës financiare të Komisionit, në Kolegji

konkludohet për balancë negative, e cila nuk do të zhbëhej dhe pse do ulej për periudhën 05.10.2007- 31.12.2007, në vlerën (-) 219.756 lekë²⁰ dhe për vitin 2008 prej (-) 1.633.636 lekësh²¹.

86. Në përmbyllje të analizës së mësipërme, lidhur me këtë shkak ankimi të subjektit të rivlerësimit Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë që investimi për ndërtimin e katit të tretë të banesës të jetë kryer para fillimit të detyrës dhe ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të mungesës së burimeve financiare të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson si të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme, të cilat sipas nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

v) *Lidhur me pasurinë e prindërve gjendje cash 1.000.000 lekë, deklaruar nga babai i subjektit në deklaratën vetting*

87. Në deklaratën *vetting*, babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar *gjendje cash në vlerën 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %, pa deklaruar burimin e krijimit*. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka konstatuar se personi i lidhur A. T. nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* burimin e ligjshëm të likuiditetit *cash* prej 1.000.000 lekësh, por duke konkluduar se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume.

88. Subjekti kundërshton konstatimin e Komisionit se personi i lidhur, babai A. T., nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* burimin e ligjshëm të likuiditetit *cash* prej 1.000.000 lekësh, duke prapësuar se pasaktësitë e mundshme të deklaratës *vetting* nga prindërit e subjektit nuk mund të penalizojnë atë. Sipas subjektit këto të ardhura nuk janë deklaruar më parë, pasi prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë qenë subjekte deklaruese, sipas ligjit nr. 9049/2003. Shuma në *cash* është pasuri e prindërve e krijuar nga kursimet gjatë gjithë jetës dhe subjekti nuk ka kontribuar në krijimin e saj. Këto të ardhura kanë rrjedhur nga puna e prindërve, si dhe nga të ardhurat e aktivitetit bujqësor.

89. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Kolegji konstaton se Komisioni në vendim ka konkluduar vetëm për detyrimin e babait të subjektit për të deklaruar burimin e krijimit të likuiditetit *cash*. Lidhur me mjaftueshmërinë e të ardhurave për krijimin e likuiditetit *cash*, Komisioni ka konstatuar se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume, prandaj dhe pretendimet e subjektit në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

90. Për sa i përket pretendimit se pasaktësitë në deklarim të prindërve nuk e penalizojnë, Kolegji sjell në vëmendje se në kuadër të procesit të rivlerësimit, deklaratimet e personave të lidhur janë edhe

²⁰ Kjo si rezultat i rishikimit të: (i) ndryshimit të likuiditeteve, pasi Komisioni ka konsideruar vlerën prej 1.013 lekësh, e cila referuar akteve në fashikuj, përbën gjendjen e likuiditeteve në bankë të subjektit dhe nënës së tij më 31.12.2007. Ndërkohë kjo vlerë për analizën e periudhës 05.10.2007-31.12.2007 do duhet të përmbante: (a) ndryshimin e likuiditeteve në bankë në datën 31.12.2007, prej 1.013 lekësh me gjendjen e likuiditeteve në datën 05.10.2007, prej 47.515 lekësh [gjendje më 05.10.2007, në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank, me balancë 40.604 lekë dhe në llogarinë e nënës së tij në “Raiffeisen Bank” prej 6.910 lekësh] në llogari të subjektit dhe nënës së tij; dhe (b) pakësimin e likuiditetit *cash* 400.000 lekë, sipas arsyetimit të Komisionit [në parag. 33], se likuiditeti *cash* prej 400.000 lekësh i deklaruar u konsiderua si i shpenzuar brenda vitit 2007], e do rezultonte se “Ndryshimet e likuiditeteve” duhej të ishin pakësim prej (-) 446.502 lekësh; (ii) reduktimi i shpenzimeve të jetesës për shkak të produkteve bujqësore, konsideruar nga Komisioni në analizë duhej të ishte i përpjesëtuar sipas muajve, ashtu si dhe llogaritja e shpenzimeve të jetesës, pra, nga 50.000 lekë në 12.500 lekë.

²¹ Kjo si rezultat duke konsideruar rishikimin e shpenzimeve të transportit nga ato të konsideruara nga Komisioni prej 169.400 lekësh në 154.700 lekë, sipas subjektit të rivlerësimit.

përgjegjësi e subjekteve të rivlerësimit për mënyrën dhe saktësinë e deklaramit. Për më tepër, Kolegji konstaton, ashtu si dhe ka konkluduar Komisioni, se vetë subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përsëritur nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurive, duke e justifikuar këtë mosveprim si një lapsus apo pasaktësi të paqëllimshme në deklarime dhe, për këtë arsye, Kolegji, për disa prej shkaqeve të ankimit, ka vlerësuar se për kriterin e pasurisë subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin, sipas shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

vi) Lidhur me konstatime të tjera të Komisionit

91. Komisioni, lidhur me përdorimin nga subjekti i rivlerësimit të automjetit në pronësi të xhaxhait G. T., në periudhën 2011-2012, ka arritur në përfundimin se në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, përtej çdo dyshimi, nuk u vërtetuan fakte dhe rrethana konkrete që të vërtetojnë a të hedhin dritë mbi dyshimet për një pronësi të mundshme të subjektit mbi këtë automjet. Por, referuar deklaramit të pakta dhe qëndrimit të subjektit gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se subjekti i është shmangur në mënyrë të përsëritur pyetjeve dhe paraqitjes së çdo lloj dokumentacioni të kërkuar, në lidhje me automjetin objekt shqyrtimi, duke mos bërë asnjë përpjekje për të hequr dyshimet. Për rrjedhojë, referuar edhe faktit, që në mënyrë të përsëritur subjekti përdor automjete që *de jure* nuk janë në pronësi të tij, Komisioni çmoi këtë qëndrim në vlerësimin tërësor të çështjes, si shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit, në konsideratë edhe të parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.
92. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se arsyetimi dhe vlerësimi i Komisionit lidhur me qëndrimin e subjektit, bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, është abuziv, pasi ky vlerësim duhet të jetë i mbështetur në rrethana objektive në mënyrë që të jetë i verifikueshëm. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me përdorimin e automjetit në pronësi të xhaxhait G. T. në periudhën 2011-2012, u është përgjigjur në çdo rast pyetësorëve brenda afatit të kërkuar dhe shpjegimet e tij kanë qenë konsistente. Subjekti ka dhënë ato sqarime që ka pasur mundësi të gjejë, pasi sendi nuk ekziston as fizikisht dhe as juridikisht, si dhe ka qenë në pamundësi të marrë dokumentacionin e mjetit në organin e ngarkuar me ligj për ruajtjen e informacionit.
93. Lidhur me këtë shkak ankimi të subjektit të rivlerësimit, Kolegji konstaton se Komisioni qëndrimin e tij e ka mbështetur në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, që ka të bëjë me bashkëpunimin e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit. Sipas Komisionit, subjekti pretendoi se nuk e ka konceptuar që i është dhënë barrë prove në lidhje me këtë automjet dhe kjo ka qenë një arsye që ka dhënë vetëm sqarime dhe nuk ka paraqitur dokumente dhe përkundër sa pretendohet, subjektit i janë kërkuar në mënyrë të qartë sqarime dhe dokumente shkresore, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ dhe qëndrimi i subjektit në secilin rast ka dëshmuar mungesën e çdo përpjekjeje të tij për të kërkuar informacion në lidhje me këtë mjet.
94. Në vlerësim të shkaqeve të ankimit, si dhe të qëndrimit të mbajtur në Komision, nga shqyrtimi i akteve në fashikull, Kolegji konstaton se:
 - 94.1. Në pyetësorin nr. 1, subjekti i rivlerësimit pyetjes, nëse ka pasur në përdorim prona të regjistruara në emrin e dikujt tjetër, i është përgjigjur se ka përdorur automjetin me targa {***}, i cili fillimisht ka qenë me targa {***}. Ky automjet ka qenë në pronësi të xhaxhait G. T. (regjistruar në emër të bashkëshortes së tij, N. T.). Këtë mjet e ka përdorur me qëllim për të dalë jashtë shtetit, në Greqi, në 4-5 raste, në vitin 2011.

94.2. Në rezultatet e hetimit, referohet se për përdorimin e automjetit, subjekti, në pyetësonin nr. 2, ka deklaruar se është përdorur prej tij me qëllim për të dalë jashtë shtetit, në Greqi, në 4-5 raste, në vitin 2011 dhe se nuk mban mend të ketë pasur aktpërdorimi apo prokurë gjatë drejtimit të këtij mjeti. Gjithashtu, ka deklaruar se ky mjet është përfituar me dhurim dhe se është shitur para disa vitesh. Subjekti nuk paraqiti dokumente për të vërtetuar lejimin e përdorimit të mjetit, aktin e fitimit të pronësisë së këtij mjeti, statusin aktual të këtij mjeti dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij mjeti. Nga Komisioni i është kërkuar subjektit të rivlerësimi të vijojë të japë sqarime e dokumente në lidhje me këto konstatime.

94.3. Lidhur me mosdorëzimin e dokumenteve, për sa i është kërkuar nga Komisioni në rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimi, në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, shprehet se automjetin, siç ka shpjeguar në përgjigjet e pyetësonit nr. 2, e ka përdorur me qëllim të përcaktuar, daljen jashtë shtetit dhe nuk ka qenë përdorim i vazhdueshëm. Nga bisedat me xhaxhanë G. T., rezulton se automjeti është shitur prej tij disa vjet më parë dhe nuk është ruajtur dokumentacioni. Për shkak se mjeti ka ndërruar pronësinë, nuk gjenerohen të dhënat e tij në *e-albania*.

94.4. Në seancën dëgjimore të datës 09.11.2021, subjekti i rivlerësimi, në përgjigje të pyetjeve mbi dokumentacionin që provonte pronësinë dhe përdorimin e automjetit, është përgjigjur se nuk e ka konceptuar si barrë prove detyrimin, por si një sqarim. Subjekti ka sqaruar se nuk kanë arritur të gjejnë asnjë dokument për automjetin dhe se xhaxhai ka kërkuar të dhëna në *e-albania* për automjetin dhe nuk i ka rezultuar asnjë e dhënë. Në pyetësonin nr. 1, subjekti ka deklaruar se pronësia mbi mjetin është fituar nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. {***} rep., {***} kol., datë 28.05.2010, (pa dorëzuar kopje të kontratës), si dhe ka dhënë listën e dokumenteve që ka paraqitur për vërtetimin e të ardhurave të G. T. dhe N. T.. Subjekti i rivlerësimi ka kërkuar në seancë edhe që t'i jepej kohë për të bërë kërkesë pranë DPSHTRr-së për të marrë dosjen e automjetit, kërkesë që nuk është pranuar.

95. Nga sa paraqitur më sipër, rezulton se subjekti, pavarësisht se nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me automjetin, e ka deklaruar përdorimin e tij që në pyetësonin e parë, si dhe ka dhënë sqarime lidhur me situatën e përdorimit të tij. Mosveprimi për t'iu drejtuar institucioneve lidhur me automjetin mund të konsiderohet si një neglizhencë dhe pakujdesi e tij, në raport me qëndrimin në tërësi gjatë hetimit administrativ, por që nuk është e një rëndësie të tillë që të përbëjë shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimi, sipas përcaktimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, Kolegji e gjen të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimi për këtë shkak ankimi.

vii) Shkaqe ankimi lidhur me analizën financiare

96. Subjekti i rivlerësimi pretendon se nga Komisioni nuk është respektuar ligji dhe parimi i sigurisë juridike, parimi i diskrecionit, proporcionalitetit dhe i objektivitetit në llogaritjen e shpenzimeve jetike. Sipas subjektit, në vështrim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nuk ka asnjë parashikim ligjor se si llogariten shpenzimet e jetesës dhe Komisioni në vendimmarrjen e tij ndaj subjektit ka shkelur parimin e sigurisë juridike, pasi mungon ligji ku duhej të referohej, si dhe ka realizuar një vendimmarrje të ndryshme bazuar në rrethana të ngjashme dhe metodologji të ndryshme. Komisionit nuk i është dhënë e drejta të ushtrojë diskrecionin në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës sipas vlerësimi të tij.

97. Gjithashtu, subjekti parashtron në ankimi se Komisioni, në shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk ka marrë për bazë rast pas rasti dhe vit pas viti strukturën e buxhetit të

familjes. Komisioni ka llogaritur përveç shpenzimeve të prezumuara, sipas strukturës së buxhetit të familjes edhe shpenzime të kryera nga subjekti, me të njëjtin qëllim dhe të të njëjtës natyrë, duke e ngarkuar subjektin dy herë me këto shpenzime. Subjekti kërkon reduktimin e shpenzimeve të llogaritura nga Komisioni, (për transportin, për udhëtimet, sipas të dhënave nga sistemi *TIMS*, për mobilimin dhe për qiranë), sipas përqindjeve që janë pjesë përbërëse e shpenzimeve të jetesës, sipas strukturës së buxhetit të familjes sipas *INSTAT*-it, përkatësisht: (a) shpenzimet e udhëtimeve të reduktohen në masën 3.2% - 5%; (b) shpenzimet e transportit, të reduktohen në masën 5.7%-6.8%; (c) shpenzimet e mobilimit, të reduktohen në masën 4.9% - 5.9%; (ç) shpenzimet e qirasë, për vitet 2009-2011, të reduktohen në masën 7.4%.

98. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve nga Komisioni, pas njohjes me rezultatet e hetimit dhe, Komisioni, në përgjigje të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, në vendim është shprehur se: *Sa i takon këtij pretendimi, Komisioni arsyeton se shpenzimet e jetesës, sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, kanë për qëllim të standardizojnë dhe unifikojnë këto shpenzime për të gjithë shtetasit shqiptarë. Këto shpenzime janë të mesatarizuara dhe përfshijnë të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat e Shqipërisë, çka do të thotë se ato nuk mund të përfaqësojnë shpenzimet reale të çdo individi dhe familjeje. Në këtë kuptim, ato përbëjnë një vlerë mesatare që përfaqëson një jetesë normale (mbi minimumin jetik) të një familjeje dhe jo shpenzime që realisht janë kryer nga subjekti dhe familja e tij. Shpenzimet e jetesës, sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, përdoren nga Komisioni në mungesë të të dhënave të dokumentuara të subjekteve të rivlerësimit. Në rastin e subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi, Komisioni ka të dhëna të evidentuara për shpenzimet e qirasë, udhëtimeve nga sistemi *TIMS*, transportit dhe mobilimit dhe, për ketë arsye, ka përdorur këto të dhëna për llogaritjen e shpenzimeve në analizën financiare.*
99. Me këtë arsyetim të Komisionit subjekti është njohur me metodologjinë e përdorur nga Komisioni, si dhe me standardet e njohura mbi të cilat bazohet kjo metodologji për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, ndaj dhe nuk qëndron pretendimi i tij për një përlllogaritje të pabazuar dhe subjektive të Komisionit.
100. Kolegji, në këtë rast, sjell në vëmendje qëndrimin e tij se *në kushtet kur shpenzimet mujore të përdorura si referencë, përfshijnë të dhëna nga anketimet për konsumin mujor mesatar të kryer nga familjet me nivele të ndryshme të ardhurash, si emërues i përbashkët që përfshin gjithë fashat e pagave dhe përfitimeve në Republikën e Shqipërisë, Kolegji vlerëson se shpenzimet e jetesës që përdoren nga institucionet e rivlerësimit në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, përbëjnë një zgjedhje tejet garantiste*²².
101. Lidhur me shpenzimet e transportit, për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk janë përcaktuar saktë ditët e punës, pasi nuk është mbajtur parasysh që kohëzgjatja e lejes vjetore për gjyqtarët nuk ka qenë 30 ditë por 40 ditë, si dhe nuk janë zbritur ditët e festave zyrtare, Kolegji vëren se në përlllogaritjet e subjektit të rivlerësimit për zbritjen nga ditët e punës dhe 10 ditë të tjera nga leje vjetore, subjekti zbret më shumë ditë pune, pasi në 10 ditë kalendarike minimalisht 2 prej tyre nuk janë ditë pune por ditë pushimi (fundjavë). Gjithsesi, në analizën në Kolegji është përlllogaritur, sipas pretendimit të subjektit për shpenzime transporti, vlera prej 154.700 lekësh (=221 ditë pune x 700 lekë/ditë) në vit të plotë, në krahasim me Komisionin, i cili ka përlllogaritur vlerën prej 169.400 lekësh, pra, 14.700 lekë më shumë.

²² *Shih vendimin e Kolegjit nr. 29/2020 (JR).*

102. Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se në analizë është ngarkuar në mënyrë të dyfishtë me shpenzime edhe për ditët për të cilat ka qenë jashtë shtetit, duke llogaritur shpenzime jetike, por edhe shpenzime për udhëtime, Kolegji vëren se lidhur me shpenzimet e përlllogaritura nga Komisioni për udhëtimet jashtë Shqipërisë, sipas të dhënave nga sistemi *TIMS*, shpenzimet e jetesës në Shqipëri, sipas publikimeve të INSTAT, janë me bazë shpenzimesh mesatare mujore dhe jo të përlllogaritura me bazë ditore në mënyrë të tillë që nuk është e mundur përlllogaritja apo ndarja e përbërjes së grupeve të ndryshme të konsumit të përshtatet në bazë ditore gjatë analizës për t'u përlllogaritur si kosto ditore në raste udhëtimesh disa ditore, ashtu siç është rasti dhe me udhëtimet e subjektit të rivlerësimit.
103. Në një qasje garantiste, Kolegji, nëse do të merrte në konsideratë pretendimet e subjektit, e duke: (i) mos konsideruar reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit sipas *TIMS*, pasi së pari, %-ja e përfshirë në shpenzimet e jetesës “Restorante dhe hotele” nuk përbën shpenzime për restorante dhe hotele jashtë vendit dhe shpenzimet e udhëtimit sipas *TIMS* përbëjnë shpenzime për udhëtime jashtë Shqipërisë, së dyti, sipas metodologjisë në faqen e INSTAT, anketa e buxhetit të familjes është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njërive ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF në Shqipëri [...], pra, kjo anketë jep informacion për shpenzime në Shqipëri dhe jo informacion për shpenzime për udhëtim dhe qëndrim që ka konsideruar Komisioni në përlllogaritjet e udhëtimit, sipas të dhënave nga sistemi *TIMS*, jashtë Shqipërisë; (ii) konsideruar reduktimin e shpenzimeve të transportit, shpenzimeve të arredimit, shpenzimeve të qirasë, sipas %-es që përfshihen në shpenzimet e jetesës në kategoritë përkatëse dhe në rastin e nëngrupeve që lidhen me këto shpenzime²³, si dhe të aplikuara këto për shpenzimet e jetesës për subjektin e rivlerësimit (1 person), pasi janë shpenzime lidhur me të, do reduktohej nga totali i shpenzimeve vlera në total për gjithë vitet prej 70.893 lekësh²⁴, vlerë kjo që dhe nëse potencialisht do të konsiderohej, nuk do të zhbënte totalin e diferencave negative në vite në analizën financiare të subjektit.
104. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se analiza financiare për periudhën e rivlerësimit duhej të bëhej e ndarë prej prindërve, Kolegji vëren se për sa kohë që subjekti ka qenë në të njëjtin trung familjar dhe ka banuar në të njëjtën ndërtesë me prindërit, analiza financiare, ashtu si dhe ka konkluduar Komisioni, duhet të jetë e përbashkët me ta nga fillimi i detyrës në vitin 2007 deri në fund të vitit 2016.
105. Për sa i përket analizës dhe tabelave financiare, Kolegji vëren, ashtu si dhe ka konstatuar subjekti i rivlerësimit në ankim, se nga Komisioni në vendim ka disa gabime në përlllogaritje në analizë²⁵. Kolegji, pasi çmon se një lapsus i tillë nuk është relevant për ndryshimin e rezultatit përfundimtar dhe të balancës negative për kriterin e pasurisë, gjen rastin për të tërhequr vëmendjen e Komisionit për mospërsëritjen këtyre gabimeve dhe pasqyrimin korrekt të të dhënave në vendimet e tij.

²³ Për shpenzimet e transportit sipas të dhënave të INSTAT për kategorinë "Transport" si 5.7%-6.8% e nëndarjen "shpenzimet që i referohen lëvizjes me mjete publike apo private", si "shpenzime për transport rrugor" për 17.7% - 32% ; për shpenzime arredimi sipas të dhënave të INSTAT për kategorinë "Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës" si 4.9%-5.4%; për shpenzime qiraje sipas të dhënave të INSTAT për kategorinë "Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira të paguar" si 7.4%-9% e nëngrupit "shpenzime për qira" si 7.8%.

²⁴ Si total i: për vitin 2007 prej 678 lekësh, për vitin 2008 prej 2.711 lekësh, për vitin 2009 prej 10.149 lekësh, për vitin 2010 prej 7.657 lekësh, për vitin 2011 prej 10.149 lekësh, për vitin 2012 prej 9.383 lekësh, për vitin 2013 prej 9.482 lekësh, për vitin 2014 prej 14.528 lekësh, për vitin 2015 prej 2.882 lekësh dhe për vitin 2016 prej 3.273 lekësh.

²⁵ Konstatohet se në vendimin e Komisionit, në paragrafin 91, vlera totale e diferencave negative është 5.963.356 lekë, ndërsa në paragrafin 93 të vendimit, në vlerësimin përfundimtar referohet si balancë negative në total vlera prej 5.993.356 lekësh, me diferencë prej 30.000 lekë më shumë.

106. Në përfundim të procesit të vlerësimit të kriterit të pasurisë, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit Ervin Trashi ka kryer deklaratime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin, sipas shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë të burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, sipas shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, në vlerën prej (-) 5.339.141 lekësh²⁶.

Shkaqe ankimi lidhur me kontrollin e figurës

107. Komisioni, në kuadër të kontrollit të figurës, nisur nga informacioni i paraqitur në raportin e DSIK-së, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar me vërtetësi deklaratën e kontrollit të figurës, sipas shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar fillimin e procedimit penal ndaj tij, regjistruar në datën 24.09.2015²⁷. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, pavarësisht faktit se sipas vendimit të pushimit të procedimit penal, gjatë hetimit të çështjes nuk ka rezultuar asnjë provë që prej subjektit të jenë konsumuar elementet e ndonjë vepre penale, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka pasur detyrimin ta deklaronte këtë fakt në formularin për kontrollin e figurës, sipas shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016. Sipas parashikimit të pikës 4, të nenit DH të Aneksit të Kushtetues, nëse subjektet kanë kryer deklaratime të pasakta, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, fakt që e penalizon subjektin Ervin Trashi dhe përbën një shkak për shkarkimin e tij nga detyra së bashku me pamjaftueshmërinë në deklaratime në lidhje me kriterin pasuror, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

108. Lidhur me konkluzionin e Komisionit, subjekti ka prapësuar në ankim se sipas interpretimit “al contrario” të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, subjektet për të cilat është marrë vendim pushimi nga prokuroria, për shkaqe të ndryshme nga fjalia e dytë e pikës 15, nuk konsiderohen “persona të përfshirë në krimin e organizuar”. Në kohën e plotësimit të Formularit nuk ka qenë person i proceduar penalisht për asnjë vepër penale, përfshirë edhe vepra të parashikuara, në pikën 1, të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Procedimi penal i regjistruar ndaj subjektit është pushuar me vendimin nr. {***}, datë 21.03.2016, bazuar në nenin 328/1, shkronja “b” të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur “fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”, pra, jo “për shkak të vdekjes ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet”, që parashikohet në nenin 328/1, shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Penale.

109. Kolegji vëren se në Raportin e DSIK-së, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ervin A. Trashi, rezulton se në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda është regjistruar procedimi penal nr. {***}, për veprat penale 319 dhe 319/ç të Kodit Penal, dhe se me vendimin e datës 21.03.2016 është vendosur pushimi i procedimit penal, pasi pas hetimeve të kryera nuk është gjetur asnjë provë që nga ana e subjektit të rivlerësimit të jenë konsumuar elementet e veprës penale. Në këtë raport është vlerësuar se nga tërësia e informacioneve që disponohen nga autoritetet verifikuese e në zbatim të kërkesave të parashikuara

²⁶ Si total i rezultateve negative: në periudhën 05.10.2007-31.12.2007, duke u ulur në vlerën (-) 219.756 lekësh; në vitin 2008, duke u ulur në (-) 1.633.636 lekë; në vitin 2009 dhe 2010, duke u konfirmuar balanca negative e Komisionit respektivisht prej (-) 107.481 lekësh dhe (-) 315.463 lekësh; në vitet 2011, 2012, 2015 dhe 2016, duke konsideruar rishikimin e shpenzimeve të transportit, e duke u ulur balanca negative respektivisht në (-) 2.123.341 lekë në vitin 2011, (-) 384.310 lekë në vitin 2012, (-) 136.806 lekë në vitin 2015 e (-) 418.348 lekë në vitin 2016.

²⁷ Sipas shkresës kthim përgjigjeje Komisionit nr. {***} prot., datë 08.10.2021, nga SPAK.

në nenin DH, pika 4 të Kushtetutës dhe pikat 8 e 15, të nenit 3, si dhe shkronjat “b” dhe “c” të nenit 7 të ligjit nr. 84/2016, mosdeklarimi nga ana e subjektit të rivlerësimit, për procedimin penal që ka pasur në ngarkim të tij, e ngarkon me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti dhe plotësimit të pasaktë dhe me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës.

110. Në formularin për kontrollin e figurës, që shoqëron deklaratën *vetting*, plotësuar sipas shtojcës numër 3 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit pyetjes “A jeni përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar” i është përgjigjur “Jo”.
111. Subjekti i rivlerësimit në pyetësin nr. 3, të dërguar nga Komisioni, është përgjigjur: *Sqaroj se në formularin për kontrollin e figurës, plotësuar sipas shtojcës numër 3 të ligjit nr. 84/2016, i jam përgjigjur në mënyrë korrekte pyetjes “A jeni përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar” me “Jo”, pasi asnjëherë nuk kam qenë i përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar. Ky fakt rezulton i provuar edhe nga vendimi, datë 21.03.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në të cilin është vendosur: “Të pushohen hetimet e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015 në ngarkim të shtetasit Ervin Trashi. Të njoftojë me këtë vendim personin nën hetim”. Nga pjesa arsyetuese e këtij vendimi rezulton si më poshtë: “Nga sa më sipër është e qartë se nga hetimi i kryer, përgjimet telefonike, përgjimet ambientale dhe vëzhgimet e kryera, nuk rezultoi asnjë provë që nga ana e gjyqtarit Ervin Trashi të jenë konsumuar elementët e ndonjë veprë penale. Në veprimet e gjyqtarit të çështjes nuk konstatohet asnjë veprim i kundërligjshëm që të përmbajë elemente të anës objektive të figurës së veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal.*
112. Në shqyrtim të këtij shkak ankimi, Kolegji sjell në vëmendje se në nenin 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se: *Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet.*
113. Kolegji, në interpretim të dispozitës së mësipërme²⁸, është shprehur se [...] *Pra, pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, është një dispozitë mjaft shtrënguese, që në “personat e përfshirë në krimin e organizuar” filtron edhe individët për të cilët procedimi penal ka filluar dhe është pushuar për shkak të vdekjes ose rastet kur personi nuk mund të merret si i pandehur, si dhe personat të cilët janë deklaruar të pafajshëm për shkak se vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose dënohet, duke përjashtuar rastin e vetëm të përfshirjes në krimin e organizuar, kur personi është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret, për subjektin e rivlerësimit është vendosur pushimi i procedimit penal, në ngarkim të tij. Në këto rrethana, duke qenë se pushimi i procedimit penal nuk parashikohet si rast përjashtimor nga neni*

²⁸ *Shih vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 10/2019 (JR).*

3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, si pasojë duhej të deklarohej nga subjekti i rivlerësimit [...]. Sipas parashikimit të pikës 15, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se, që një person të konsiderohet “i përfshirë në krimin e organizuar”, në kuptim të këtij ligji: Duhet të jetë i proceduar penalisht për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009. Në kuptim të dispozitave procedurale penale, statusin e personit të proceduar penalisht e merr ai shtetas të cilit i regjistrohet emri në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, në zbatim të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, ku prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet, duke shënuar edhe emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale; b) Personi i cili është proceduar për veprën si më lart nuk duhet të jetë deklaruar i pafajshëm me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

- 114.** Nga qëndrimi i mësipërm i Kolegjit, si dhe në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se subjekt i rivlerësimit ka qenë i proceduar penalisht për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009²⁹ dhe për të nuk ka pasur një vendim pafajësie. Për pasojë, subjekti konsiderohet nga ligji si person i përfshirë në krimin e organizuar për efekt të procesit të rivlerësimit dhe ka pasur detyrimin ta deklaronte këtë fakt në deklaratën për kontrollin e figurës.
- 115.** Për sa i përket pretendimit të subjektit se çështja është pushuar, Kolegji tërheq vëmendjen se konkluzioni i Komisionit lidhur me kontrollin e figurës nuk ka të bëjë me vlerësimin e çështjes penale në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, por me detyrimin që ai ka pasur për të deklaruar procedimin penal ndaj tij në formularin e kontrollit të figurës, sipas shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016, detyrim të cilin ai nuk e ka përmbushur.
- 116.** Për sa më sipër, në përfundim, Kolegji çmon se, në kundërshtim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, është i bazuar konkluzioni i Komisionit se [...] *subjekti ka pasur detyrimin ta deklaronte këtë fakt në formularin për kontrollin e figurës, sipas shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016. Sipas parashikimit të pikës 4, të nenit DH të Aneksit të Kushtetues, nëse subjektet kanë kryer deklarime të pasakta, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, fakt që e penalizon subjektin Ervin Trashi dhe përbën një shkak për shkarkimin e tij nga detyra [...].*
- 117.** Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ervin Trashi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme dhe gjendet në kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit D, në pikën 4, të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 474, datë 12.11.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

²⁹ *Vepra penale të parashikuara në nenet 319 (Korrupsioni aktiv i gjyqtarit), 319/ç, (Korrupsion pasiv i gjyqtarëve), të Kodit Penal.*

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 474, datë 12.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 15.12.2022, në Tiranë.

ANËTARE	ANËTARE	ANËTARE
Albana SHTYLLA	Ina RAMA	Natasha MULAJ
<i>nënshkrimi</i>	<i>nënshkrimi</i>	<i>nënshkrimi</i>

RELATORE	KRYESUES
Mimoza TASI	Sokol ÇOMO
<i>nënshkrimi</i>	<i>nënshkrimi</i>

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e relatores, jam dakord me vendimin nr. 48, datë 15.12.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 474, datë 12.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, por kam mendim paralel me shumicën e trupit gjykues, për sa i përket qëndrimit të mbajtur dhe konkluzionit të arritur, lidhur me një nga pasuritë e subjektit të rivlerësimit, konkretisht me pasurinë shtëpi banimi, adresa: lagjja “{***}”, rruga “H. S.”, Lushnjë, në pronësi të prindërve, si dhe të analizës financiare kryer për këtë pasuri së bashku me prindërit.
2. Kolegji në paragrafin 86 të vendimit, për këtë pasuri, ka konkluduar se: *Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë që investimi për ndërtimin e katit të tretë të banesës të jetë kryer para fillimit të detyrës dhe ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të mungesës së burimeve financiare të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson si të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme, të cilat, sipas nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.*
3. Pas njohjes me aktet në fashikull dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësoj se për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit nuk duhej të ngarkohej nga shumica e trupit gjykues me pasojën e deklaramit të pasaktë e të pamjaftueshëm, sipas nenit 33/5/b të ligjit nr. 84/2016, duke përbërë shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61/3 të po këtij ligji. Mendimin tim e bazoj në argumentet sa më poshtë.
4. Pasuria shtëpi banimi, me adresë: lagjja “{***}”, rruga “H. S.”, Lushnjë, është deklaruar në deklaratën *vetting* nga personi i lidhur, babai i subjektit të rivlerësimit dhe provohet që të jetë në pronësi të këtij të fundit. Subjekti ka jetuar në këtë shtëpi dhe e ka deklaruar edhe si adresë banimi në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaratat periodike 2007-2017, ashtu si ka konstatuar edhe Kolegji në paragrafin 79 të vendimit.
5. Rezulton e provuar se në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 22.02.2013, figuron në pronësi të A. H. T., pasuria nr. {***}, me sip. 220,8 m², në adresën e llojit truall + ndërtesë (shtëpi banimi 3 kate: kati përdhe = 162,5 m²; kati parë = 194,5 m², kati dytë = 197,6 m²). Banesa është ndërtuar para vitit 2006, vërtetuar nga formulari i vetëdeklarimit të legalizimit të objektit, datë 06.09.2006, pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore Lushnjë. Objekti është legalizuar me lejen e legalizimit Nr. {***}, datë 31.01.2013, lëshuar nga ALUIZNI, Dega Lushnjë. Pra, të gjitha veprimet juridike të kryera për këtë pasuri rezultojnë që të jenë në emër të babait të subjektit të rivlerësimit (proces legalizimi, regjistrimi).
6. Gjithashtu, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk është bashkëpronar në këtë pasuri, filluar për t’u ndërtuar gjatë kohës që ai ka qenë student, përpara se të fillonte punën si gjyqtar. Subjekti i rivlerësimit nuk është bashkëpronar me prindërit në pasuritë e tyre dhe prindërit e tij nuk janë bashkëpronarë me subjektin e rivlerësimit në pasuritë individuale të tij. Në këtë shtëpi ai ka vetëm të drejta banimi dhe nga aktet në fashikull nuk rezulton kontribut i subjektit për ndërtimin e katit të tretë (papafingo) e, për këtë arsye, në vlerësimin tim nuk duhej që vlera e ndërtimit të katit të tretë të përfshihej në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit nga ana e shumicës së trupit gjykues.
7. Komisioni i ka vlerësuar si ekonomi e përbashkët subjektin me prindërit, pavarësisht se subjekti nuk e ka dhënë ndonjë shpjegim të tillë. Subjekti ka shpjeguar në ankim se *ka jetuar me prindërit, si djali i tyre, për shpenzimet e tij ushqimore ka paguar një shumë fikse mujore, por nuk ka kontribuar në krijimin*

e pasurisë, ndryshe do të ishte bashkëpronar me prindërit në pasuri. Gjithashtu, Komisioni, pasi nuk ka pranuar provat e paraqitura nga subjekti, e ka konsideruar të mirëqenë faktin që subjekti ka investuar për ndërtimin e katit të tretë, pa asnjë të dhënë tjetër, por nisur vetëm nga fakti që subjekti i rivlerësimit ka vijuar të banojë në banesën e prindërve. Por, Komisioni dhe shumica e Kolegjit nuk kanë marrë në konsideratë që në shtëpinë e banimit në fjalë ka banuar në vazhdimësi edhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk rezulton që të jetë bërë një hetim lidhur me kontribute të mundshme të vëllait të subjektit për ndërtimin e banesës së prindërve. Për rrjedhojë, edhe hetimi i kryer nga Komisioni është jo i plotë dhe, për këtë arsye, edhe konkluzioni i tij lidhur me këtë pasuri mbetet i paqartë.

8. Konkluzioni i Komisionit, i konfirmuar në vendimin e Kolegjit se subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme ndërtimin e katit të tretë (papafingo) gjatë periudhës që ka qenë në detyrë, duke e përfshirë në analizën e tij financiare dhe duke i ngarkuar një pamjaftueshmëri për periudhën 05.10.2007-31.12.2007, në vlerën (-) 219.756 lekë dhe për vitin 2008 prej (-) 1.533.636 lekësh, në vlerësimin tim është i pabazuar në fakte dhe në prova.
9. Edhe pse shumica e Kolegjit referon si argumente në mbështetje të konkluzionit disa deklarime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, babait, për kohën e ndërtimit të katit të tretë, datën e fotografimit satelitor nga të dhënat e Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor më 14.04.2007³⁰, ku ndërtesa nuk e ka pasur çatinë e pjerrët, si dhe procesverbalin e konstatimit nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI Qarku Fier, të datës 05.01.2009, vlerësoj se këto argumente nuk janë të bazuara për sa kohë shumica e trupës së Kolegjit nuk arriti që të japë një kohë të saktë të ndërtimit të katit të tretë, por e përcaktoi atë në mënyrë evazive në fashën kohore 14.04.2007-05.01.2009, duke rënduar pozitën e subjektit.
10. Kolegji duhej të merrte në konsideratë provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, për kohën e përfundimit të katit të tretë të banesës para datës së fillimit të detyrës, 5.10.2007, që janë: (a) deklarata me vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., datë 28.10.2021, të shtetasit M. H., i regjistruar si person fizik në fushën e ndërtimit, i cili deklaroi se është kontraktuar në gusht të vitit 2007 për ndërtimin e çatisë duke e përfunduar brenda muajit gusht të atij viti; (b) fatura e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 02.08.2007, sipas së cilës rezultojnë punime për ndërtim çatie kati III, materiale + punëtor, me sip. 170 m², në total në shumën 510.000 lekë. Këto prova, (veçanërisht fatura e thjeshtë tatimore), japin një panoramë më të qartë për kohën e saktë të përfundimit të katit të tretë, në ndryshim nga fasha kohore prej më se 21 muajsh, e papërcaktuar në periudhën 14.04.2007 -05.01.2009.
11. Në vlerësimin tim, edhe pse kjo pasuri iu nënshtrua kontrollit nga Komisioni dhe Kolegji për qëllim të procesit të rivlerësimit, për të cilin jam dakord³¹, nuk duhej që ndërtimi i katit të tretë, (papafingo), t'i ngarkohej subjektit të rivlerësimit, në kuptim të kontributit financiar të dhënë prej tij, vetëm sepse subjekti rezulton që të jetë në certifikatën familjare së bashku me prindërit. Vetëm qenia në të njëjtën certifikatë familjare nuk i jep subjektittribute të tjera ligjore prej të cilave të derivojë detyrueshmëria për nënshtrimin ndaj kontrollit të pasurisë për procesin e rivlerësimit për këtë pasuri, duke e lidhur me kohën limit të fillimit të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit më datë 05.10.2007. Nga aktet në fashikull provohet qartë që pronësia e kësaj pasurie është vetëm e babait të subjektit A. T., e deklaruar edhe në deklaratën *vetting* nga personat e lidhur, babai dhe nëna, madje duke përcaktuar edhe pjesën e tyre takuese në përqindje (50 me 50)%. Personat e lidhur, prindërit, janë hetuar vetëm për shkak të qenies në të njëjtën certifikatë të gjendjes civile me subjektin, ndërkohë që nuk ka asnjë marrëdhënie financiare

³⁰ Kolegji shprehet në paragrafin 80 të këtij vendimi se: *Fakti i ndërtimit të katit të tretë pas datës 14.04.2007 është pranuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit [...]”.*

³¹ *Jam dakord me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në paragrafin 78 të këtij vendimi.*

midis tij dhe prindërve. Gjatë periudhës së ndërtimit të shtëpisë rezulton se subjekti ka qenë duke ndjekur arsimin e lartë dhe, më pas, Shkollën e Magjistraturës dhe të tri katet e shtëpisë janë ndërtuar pa kontributin e tij.

12. Në përfundim, në lidhje me pasurinë shtëpi banimi, adresa: lagjja “{***}”, rruga “H. S.”, Lushnjë, në pronësi të prindërve, si dhe të analizës financiare kryer për këtë pasuri së bashku me prindërit, çmoj se subjekti i rivlerësimit Ervin Trashi nuk duhej të ngarkohej me pasojën e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi